

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 9 numër 2 janar 2007

Data e botimit 13.02.2007

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.05, datë 31.01.2007 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2006" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.07, datë 31.01.2007 "Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"" 51
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 31.01.2007 "Për zgjatjen e afatit njëvjeçar të vlefshmërisë së miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve-Shqipëri sh.a."" 53
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 1, Janar 2007 54



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.05, datë 31.01.2007

PËR

MIRATIMIN E DEKLARATËS SË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË
SHQIPËRISË PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2006

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997
"Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit
të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Deklaratën e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e kësaj deklarate në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

YLLI MEMISHA

KRYETARI

ARDIAN FULLANI

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2006

1. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare është karakterizuar nga tendenca pozitive zhvillimi gjatë viteve të fundit, të shprehura në ritme të qëndrueshme të rritjes ekonomike, në përmirësim të vazhdueshëm të stabilitetit makroekonomik dhe në përafrimin gradual të strukturës së ekonomisë me ato të ekonomive të zhvilluara. Reformat strukturore dhe qëndrueshmëria e treguesve makroekonomikë, kanë mbështetur potencialin ekonomik të sektorit privat, duke gjeneruar ritme të qëndrueshme rritjeje ekonomike në nivelin 5-6 për qind.

Kjo trajektore zhvillimi është ruajtur edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006. Sipas treguesve të prodhimit dhe konsumit, ecuria e ekonomisë ka qenë në përputhje me programin e zhvillimit të vendit. Përmirësimi i situatës ekonomike në Eurozonë dhe frenimi i rritjes së çmimit të naftës, kanë favorizuar ecurinë e ekonomisë vendase. Duke u nisur nga zhvillimet e faktuara të tremujorit të tretë dhe trendet e konstatuara gjatë tremujorit të katërt, gjykohet se situata e prodhimit ka vazhduar të jetë e mirë dhe përgjithësisht në përputhje me parashikimet. Në ndryshim nga zhvillimet e gjashtëmujorit të parë, në gjysmën e dytë të vitit, bilanci fiskal ka regjistruar deficit si pasojë e përshpejtimit në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Sektori i jashtëm ka shfaqur shenja përmirësimi të manifestuara në zbutjen e lehtë të deficitit korent. Zhvillimet në tregun valutor kanë ndjekur ecurinë e tregut ndërkombëtar, duke mos rrezikuar balancat makroekonomike në vend.

Kërkesa e brendshme ka qëndruar në nivele të përshtatshme për të mbështetur rritjen ekonomike, ndërkohë që efekti i rritjes sezonale të kërkesës mbi çmimet e konsumit gjatë muajit dhjetor ka qenë më i moderuar në krahasim me vitet e mëparshme. Rishfaqja e kufizimeve në furnizimin me energji elektrike, gjatë gjysmës së dytë të muajit dhjetor, përbën një zhvillim të ri. Prania e saj edhe në muajin e parë të vitit 2007 shtron domosdoshmërinë e një analize të plotë, për të arritur në konkluzione të besueshme mbi efektet e mundshme negative, të drejtpërdrejta apo indirekte. Banka e Shqipërisë vlerëson të domosdoshme hedhjen e hapave konkretë në drejtim të ndërtimit të burimeve alternative të energjisë, për të minimizuar varësinë e madhe të vendit ndaj kushteve atmosferike. Banka e Shqipërisë gjykon se përsëritja kronike e krizave të kësaj natyre do ta konvertojë këtë problem në një faktor të përhershëm, zhvillim që ka si pasojë faktorizimin e saj në kostot e prodhimit apo të shërbimit.

Duke u ndalur në aktivitetin ekonomik të vitit të kaluar, bazuar në informacionin statistikor që është në dispozicion, vlerësohet se ecuria e prodhimit gjatë vitit 2006, sipas treguesit të shitjeve të ndërmarrjeve ekonomike, ka qenë e kënaqshme. Norma e rritjes së shitjeve në bazë vjetore për nëntëmuorin e parë ishte rreth 11 për qind, duke qenë pranë normës mesatare të rritjes së pesë viteve të fundit. Të dhënat mbi prodhimin sinjalizojnë se sektori i industrisë po shfaq shenja të forta rimëkëmbjeje, të vërejtura sidomos në industrinë përpunuese. Kjo e fundit është zhvilluar me ritme të shpejta gjatë vitit 2006, duke regjistruar një ndër normat më të larta të rritjes sektoriale prej 27 për qind në tremujorin e tretë të vitit. Një sektor tjetër, që vazhdon të zhvillohet me shpejtësi është ai i tregtisë. Ky sektor, ka regjistruar vazhdimisht norma të larta rritjeje vjetore, duke dhënë njëkohësisht kontributin më të lartë në rritjen e shitjeve të ekonomisë. Sektori i ndërtimit, pavarësisht rritjes pozitive vjetore në tremujorin e tretë, ka shfaqur shenja ngadalësimi, në krahasim me vitet e mëparshme. Ngadalësim është vërejtur gjithashtu në sektorin e transportit, ndërkohë që shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimet e tjera kanë shënuar rritje si në bazë vjetore, ashtu edhe në bazë tremujore gjatë pjesës së dytë të vitit.

Tregu i punës gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006, ka regjistruar të njëjtit tregues me ata të dy tremujorëve të mëparshëm. Norma e papunësisë arriti në nivelin 13.8 për qind, ndërkohë që konstatohet një zhvendosje e të punësuarve nga sektori shtetëror, në sektorin privat jobujqësor.

Inflacioni i çmimeve të konsumit gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2006, ka qenë pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë, duke u luhatur në intervalin e poshtëm të tolerancës. Çmimet e konsumit janë rritur me mesatarisht 2.7 për qind gjatë gjashtëmuorit të dytë, ndërkohë që inflacioni mesatar vjetor kapi nivelin 2.4 për qind. Fakti që inflacioni mesatar vjetor në katër vitet e fundit është luhatur në intervalin 2-3 për qind, është tregues se inflacioni tashmë është stabilizuar në nivele të qëndrueshme dhe komode për ecurinë e ekonomisë së vendit. Profili i rritjes së çmimeve gjatë gjashtëmuorit të dytë është dominuar nga rritja e çmimit të energjisë elektrike. Rritja vjetore prej 13.7 për qind në çmimin e energjisë u shoqërua edhe me rritjen e çmimeve të qirave, sidomos në muajt shtator-tetor. Presione në drejtim të rritjes së inflacionit ka ushtruar edhe grupi "Pije alkolike dhe duhan" si pasojë e rritjes së akcizave në muajin shtator. Efekti balancues gjatë kësaj periudhe ka ardhur nga grupi i mallrave ushqimorë, çmimet e të cilit kanë regjistruar rënie në muajt shtator-tetor dhe vlera të ulëta pozitive në muajt e tjerë. Vlen të theksohet se rritja e çmimeve të konsumit edhe duke përjashtuar efektin e çmimeve të administruara, mbetet nën kontroll dhe pranë vlerës së synuar nga Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, financimi i deficitit buxhetor nëpërmjet huamarrjes së brendshme ka qenë i ulët gjatë pjesës së dytë të vitit. Kërkesa e qeverisë për mjete monetare ka dhënë një ndikim të kontrolluar në zgjerimin e burimeve monetare. Treguesit fiskalë kanë qenë brenda

vlerave të programuara për këtë periudhë, edhe në kushtet e shifrave të rishikuara. Në këtë aspekt, politika fiskale nuk ka cënuar ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë.

Zhvillimet në llogarinë korente deri në tremujorin e tretë të vitit 2006, tregojnë për një aktivitet intensiv të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Vëllimi i transaksioneve në llogarinë korente, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, kapi nivelin 5 miliardë euro, duke qenë 17 për qind më i lartë sesa ai i të njëjtës periudhë për vitin 2005. Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë një nga burimet kryesore të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh. Gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2006 ato janë vlerësuar në nivelin 683 milionë euro ose 24 milionë euro më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo prirje zbutëse e tyre kërkon një monitorim të kujdesshëm dhe marrjen e masave për gjenerimin e burimeve më të qëndrueshme valutore në një perspektivë afatgjatë.

Në përgjigje të zhvillimeve ekonomike të sipërpërmendura, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare të kujdesshme, duke synuar balancimin e stimullit financiar të ekonomisë me nevojën e ruajtjes së stabilitetit monetar dhe kontrollin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Zhvillimet ekonomike dhe financiare krijuan sfida të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006. Presionet inflacioniste gjatë kësaj periudhe origjinuan, kryesisht nga goditjet e ofertës, por edhe komponenti i kërkesës filloi të bëhej një faktor i rëndësishëm në formimin e normës së inflacionit. Ky i fundit është ushqyer gjithnjë e më shumë nga kreditimi i vrullshëm i sistemit bankar gjatë tre viteve të fundit, duke mbështetur rritje në investimet e bizneseve dhe rritjen e konsumit.

Për t'i paraprirë lindjes së presioneve inflacioniste dhe reflektimit të tyre në pritjet e ekonomisë, Banka e Shqipërisë shtrenjtoi koston e parasë në ekonomi. Kjo lëvizje u krye në dy hapa, në muajt korrik dhe nëntor, dhe solli rritjen e normës bazë të interesit, nga 5.0 në 5.5 për qind. Shtrenjtimi i koston e parasë synoi ruajtjen e kushteve monetare të përshtatshme për garantimin e stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatgjatë. Ridimensionimi i incentivave për konsum e kursim në ekonomi dhe rivlerësimi i faktorëve mbështetës të kursit të këmbimit, do të mundësojnë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve brenda parametrave të shpallur nga Banka e Shqipërisë gjatë muajve të ardhshëm. Gjithashtu, shtrëngimi i kushteve monetare është në linjë me politikën monetare të ndjekur nga bankat e mëdha qendrore dhe me rritjen e normave të interesit në tregjet valutore ndërkombëtare. Në ndjekje të sinjaleve shtrënguese, normat e interesit në tregun e parasë kanë qenë në rritje gjatë kësaj periudhe.

Zhvillimet monetare në gjashtëmuajorin e dytë të vitit, janë kushtëzuar nga rritja graduale e kërkesës së qeverisë për mjete monetare. Në përgjigje të saj, ritmi i rritjes së ofertës monetare u rrit në 12.7 për

qind në muajin nëntor, kundrejt vlerës 9.7 për qind në muajin qershor. Megjithatë, ritmet aktuale të zgjerimit vjetor të agregatëve monetarë rezultojnë dukshëm më të ulëta kundrejt ritmeve prej 17-18 për qind të dy viteve të fundit. Gjithashtu, pakësimi gradual i peshës së parasë në qarkullim favorizon monetizimin e ekonomisë, rritjen e shkallës së ndërmjetësimit financiar dhe të rolit të sistemit bankar.

Kreditimi i ekonomisë mbetet kontribuesi kryesor i rritjes së mjeteve monetare në ekonomi. Ai ka vijuar të shënojë rritje të shpejtë edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006. Portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë arriti në 179.5 miliardë lekë në muajin nëntor 2006, duke përbërë 28.1 për qind të mjeteve monetare të ekonomisë. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto, ky portofol ndodhet në nivelin më të lartë historik të dhjetë viteve të fundit - 20.1 për qind.

Megjithatë, ritmi vjetor i zgjerimit të kredisë për ekonominë ka shënuar rënie në terma relativë, duke zbritur nga 67.1 për qind në muajin qershor në 57.8 për qind në muajin nëntor. Ngadalësimi i ritmit të rritjes ka ardhur si rezultat i nivelit të lartë të kreditimit për një periudhë 2-vjeçare, i ngopjes së disa segmenteve të tregut dhe sinjalizimit nga Banka e Shqipërisë të shtrëngimit të masave rregullatore që kontrollojnë cilësinë e portofolit. Banka e Shqipërisë pret që vënia në zbatim e këtij seti rregullator gjatë vitit 2007, të ndikojë në kontrollin e ritmit të ekspansionit të kredisë, në përputhje me stabilitetin makroekonomik të vendit në një periudhë afatgjatë.

Banka e Shqipërisë mbetet një institucion i përgjegjshëm dhe transparent, në themel të punës së të cilit qëndron angazhimi ligjor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe vullneti institucional për nxitjen dhe zhvillimin e tregjeve financiare. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ka hartuar dhe miratuar kuadrin e saj politik dhe operacional për vitin 2007, të finalizuar në Dokumentin e Politikës Monetare dhe Programin Monetar për vitin 2007. Këto dy dokumente përvijojnë qartë objektivat tanë strategjike, në drejtim të stabilitetit ekonomik dhe atij financiar.

Banka e Shqipërisë gjykon se objektivat e zhvillimit ekonomiko-financiar të vendit për vitin 2007 janë realistë. Gjithsesi, ata imponojnë një ndjekje të kujdesshme të tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse, veçanërisht në fushën e reformave strukturore të ekonomisë, dhe një koordinim të mirë të politikave makroekonomike.

2. ZHVILLIMET EKONOMIKE TË GJASHTËMUJORIT

2.1 EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore ka vijuar të shënojë zhvillime pozitive edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2006. Impulsi i rritjes i gjeneruar nga ekonomitë aziatike, në mënyrë të veçantë nga Kina dhe India, ka vazhduar të jetë i

fortë, ndërkohë që ekonomia e ShBA-së ka shfaqur shenja ngadalësimi. Zhvillimet në Eurozonë dhe Japoni sinjalizojnë një përmirësim të situatës ekonomike. Në një pamje të përgjithshme vlerësohet se rritja e ekonomisë botërore do të ngadalësohet disi për periudhën në vazhdim, por ritmet e rritjes do të vazhdojnë të mbeten në nivele të kënaqshme.

Rritja e çmimit të naftës dhe të produkteve të saj ka rritur presionet inflacioniste në një pjesë të madhe të ekonomive. Megjithatë, si ndikimi i drejtpërdrejtë ashtu edhe ndikimi dytësor, ka qenë i kufizuar. Efekti i çmimit të lartë të naftës në inflacionin bazë gjatë vitit 2006, ka qenë i moderuar për pjesën më të madhe të vendeve. Një rol të rëndësishëm në ecurinë e çmimeve ka luajtur politika monetare me kah shtrëngues, e ndjekur nga shumë banka qendrore. Materializimi i efekteve të politikës monetare shtrënguese dhe rënia e çmimit të naftës gjatë vjeshtës së vitit 2006, pritet të kontribuojnë në zbutjen e presioneve inflacioniste për periudhën në vazhdim.


Tabelë 1. Disa tregues kryesorë ekonomikë në terma vjetorë (në përqindje).

	Rritja vjetore e PBB-së, T3	Norma e papunësisë	Inflacioni i çmimeve të konsumit, nëntor 2006
SHBA	+3.0	4.5 (dhjetor)	2.0
Eurozonë	+2.7	7.6 (nëntor)	1.9
Gjermani	+2.3	8 (nëntor)	1.5
Francë	+1.9	8.6 (nëntor)	1.6
Itali	+1.9*	6.9 (qershor)	2.0
Japoni	+1.0	4.0 (nëntor)	0.3

* Tremujori i dytë.

Burimi: Eurostat; Zyra e Kërkimeve Ekonomike; Zyra e Statistikave të Punës; BQE, Raporti i muajit dhjetor.

Grafik 1. Normat bazë të interesit (në përqindje).



Burimi: Banka Qendrore Evropiane dhe Rezerva Federale New York, janar 2007.

Ekonomia e Eurozonës

Sipas të dhënave paraprake të Eurostat-it, rritja reale vjetore për tremujorin e tretë të vitit 2006 në Eurozonë ishte 2.7 përqind. Pavarësisht se ritmi i rritjes nuk ka qenë aq i lartë sa gjatë pjesës së parë të vitit, zhvillimet ekonomike konsiderohen të kënaqshme dhe me një bazë të gjerë. Forca shtytëse e aktivitetit ekonomik për tremujorin e tretë ishte kërkesa e brendshme. Ajo ka kontribuar me 0.6 pikë përqindjeje në rritjen vjetore. Kontributi i eksporteve neto, që pasqyron zhvillimet në kërkesën së jashtme, ka qenë negativ. Anketimet e ndryshme dhe treguesit në formën e indekseve të besimit të industrisë dhe shërbimeve, sinjalizojnë se zhvillimet ekonomike në Eurozonë vlerësohen si të qëndrueshme. Pavarësisht se jo të gjithë treguesit janë rritur me të njëjtin ritëm, normat e rritjes janë mbi mesataret historike të tyre.

Tregu i punës i Eurozonës ka regjistruar zhvillime pozitive gjatë gjithë vitit 2006. Rritja në normën e punësimit vazhdoi të ishte e lartë edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit, dhe norma e papunësisë u stabilizua gjatë muajit nëntor, në vlerën më të ulët të këtyre dhjetë viteve të fundit. Pritjet për tremujorin në vijim janë sërish pozitive, duke mbështetur skenarin e rritjes së qëndrueshme në punësim për periudhën afatshkurtër.

Gjatë vitit 2006 inflacioni i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit është luhatur rreth vlerës mesatare 2.2 për qind. Zhvillimet në çmimin e naftës dhe të produkteve të saj, kanë përcaktuar drejtimin e inflacionit total gjatë pjesës më të madhe të vitit. Ndërkaq, ecuria e çmimeve të prodhimit vazhdon të tregojë për presione inflacioniste si pasojë e rritjeve të kaluara në çmimin e naftës dhe në çmimin e mallrave të tjerë. Presionet nga kostot e punës mbeten të kufizuara.

Në mbledhjen e muajit dhjetor, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e çuar në nivelin 3.5 për qind. Këshilli e mori këtë vendim me qëllim që të evitonte materializimin e rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e çmimeve në periudhën afatmesme. Sipas BQE-së, politika monetare e Eurozonës vijon të mbështesë zhvillimet në ekonomi, nëpërmjet normave të ulëta të interesit, rritjes së lartë të kredisë dhe ruajtjes së likuiditetit në nivele të kënaqshme.

Ekonomia e ShBA-së

Ritmi i lartë i rritjes së ekonomisë së ShBA-së ka shfaqur shenja ngadalësimi gjatë vitit 2006. Gjatë tremujorit të tretë, rritja reale vjetore e prodhimit të brendshëm bruto ishte 3 për qind. Kjo është norma më e ulët e regjistruar që nga tremujori i tretë i vitit 2003. Arsyeja kryesore pas kësaj tendence zbritëse lidhet me rënien prej rreth 8 për qind të investimeve nga rezidentët. Efekti negativ i tregut të banesave pritët të balancohet pjesërisht nga rritja e investimeve të korporatave. Situata e biznesit mbetet e shëndetshme, duke sugjeruar se kjo situatë pozitive do të vazhdojë edhe gjatë periudhave të ardhshme.

Pas thellimit të vazhdueshëm gjatë muajve të parë të vitit, deficitit i bilancit tregtar është ngushtuar që prej muajit shtator. Në muajin nëntor, deficitit i bilancit tregtar kapi vlerën 58.2 miliardë usd. Rritja e eksporteve dhe rënia e importeve, e mbështetur nga rënia e çmimit të naftës si edhe nga kufizimi i sasisë së importuar, kanë kontribuar njëkohësisht në përmirësimin e bilancit tregtar.


Niveli i lartë i përdorimit të burimeve në ekonominë amerikane mund të favorizojë presionet inflacioniste. Por, frenimi i rritjes së çmimit të naftës, pritjet për norma të moderuara të inflacionit dhe efekti i akumuluar i veprimeve të politikës monetare kanë frenuar kërkesën e brendshme, duke u reflektuar në një tendencë rënëse të inflacionit të çmimeve të konsumit. Që pas muajit gusht, i cili regjistroi një normë

kulmore inflacioni prej 3.8 për qind në terma vjetorë, ky tregues ka shënuar ulje të pandërprerë. Në muajin nëntor, inflacioni vjetor shënoi vlerën 2.0 për qind. Në mbledhjen më të fundit të FOMC¹-së, në 12 dhjetor 2006, komiteti vendosi të linte të pandryshuar në nivelin 5.25 për qind normën bazë të interesit.

Kursi i këmbimit


Në muajt e fundit të vitit monedha e Eurozonës fitoi pikë kundrejt dollarit amerikan, pas një periudhe disamujore stabiliteti në kursin spot të këmbimit. Dollari amerikan ka humbur terren edhe kundrejt poundit britanik dhe jenit japonez, gjatë muajve të fundit të vitit. Sinjalet për një ngadalësim në aktivitetin ekonomik të ShBA-së dhe për qëndrueshmërinë e rritjes në Eurozonë duket se kanë influencuar pritjet e tregjeve ndërkombëtare, duke ndikuar në dobësimin e monedhës amerikane si ndaj monedhës evropiane, ashtu edhe kundrejt shportës së monedhave të partnerëve kryesorë tregtarë të ShBA-së.

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit euro/usd dhe kursi nominal efektiv² i euros dhe dollarit, për vitin 2006.



Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Rezerva Federale ShBA-së.

Grafik 3. Ecuria e çmimit të një fuçie naftë të papërpunuar, WTI, 2005-2006 (në dollarë amerikanë për fuçi).



Burimi: Bloomberg.

Çmimi i naftës

Gjatë periudhës së verës së vitit 2006 çmimi i naftës arriti nivele rekord. Në fillim të muajit gusht, çmimi i një fuçie naftë arriti shifrën e 78 dollarëve amerikanë. Rritja e madhe e çmimit ishte rezultat i panikut që u krijua rreth uljes së mundshme të prodhimit nga ana e vendeve eksportuese të naftës, si pasojë e tensioneve të shtuara gjeopolitike gjatë kësaj periudhe. Çmimi i naftës ka rënë ndjeshëm gjatë muajve të fundit, kryesisht sepse disa nga faktorët që ndikuan në rritjen e çmimit gjatë periudhës të verës nuk u materializuan ose nuk patën efektin e pritur. Niveli i lartë i inventarëve, zvogëlimi i kërkesës për naftë dhe ngadalësimi i aktivitetit të ekonomisë amerikane, janë reflektuar në uljen e kërkesës për këtë produkt. Çmimi i naftës gjatë dy muajve të fundit të vitit është ndikuar edhe nga kushtet e favorshme atmosferike, gjë që ka reduktuar kërkesën për lëndë djegëse.

Megjithatë, vendet e OPEC-ut kanë treguar qartë se do të përpiqen që të mbajnë në nivele të larta çmimin e naftës dhe të produkteve të saj. Në fund të muajit tetor, organizata e vendeve të OPEC-ut vendosi që të zvogëlonte prodhimin me 1.2 milion fuçi në ditë. Ky është vendimi i parë për ulje të prodhimit nga kjo organizatë, që prej vitit 2003.

2.2 EKONOMIA SHQIPTARE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2006

Ekonomia shqiptare gjatë gjashtëmujsorit të dytë është karakterizuar nga zhvillime përgjithësisht pozitive si në sektorin real, ashtu edhe në sektorët e tjerë. Rritja ekonomike vlerësohet të ketë regjistruar nivele të kënaqshme, ndërkohë që çmimet e prodhimit dhe të konsumit kanë shënuar rritje të moderuar. Në ndryshim nga gjashtëmujsori i parë, bilanci fiskal regjistroi deficit gjatë muajve tetor-nëntor si pasojë e përshpejtimin të rritjes së shpenzimeve buxhetore. Tregu valutor vendas ka regjistruar një mbiçmim të lekur ndaj dollarit amerikan dhe një ecuri të qëndrueshme të lekur kundrejt euros. Rënia e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është reflektuar në rënie, ndonëse jo me të njëjtat ritme, të çmimit të naftës edhe në tregun vendas. Rritja sezonale e çmimeve të konsumit gjatë muajit dhjetor, këtë vit u manifestua në një shkallë më të ulët sesa në vitet e mëparshme. Ndikimi i situatës së rënduar të energjisë mbi ecurinë e prodhimit gjatë fundit të vitit 2006 dhe fillimit të vitit 2007, mbetet për t'u vlerësuar në të ardhmen.

Rritja ekonomike gjatë vitit 2006 është nxitur nga ecuria e disa sektorëve-kyçë të aktivitetit ekonomik si ndërtimi, industria dhe shërbimet.

	2005			2006		
	Rritja (%)	Pesha (%)	Kontributi (p.p)	Rritja (%)	Pesha (%)	Kontributi (p.p)
Bujqësia	2.6	21.9	0.6	3.0	21.5	0.6
Industria	12.0	9.5	1.1	11.0	10.1	1.1
Ndërtimi	15.0	16.5	2.5	10.3	17.3	1.8
Transporti	7.0	7.8	0.5	7.0	8.0	0.6
Shërbimet	1.9	44.3	0.8	2.1	43.1	0.9
PBB	5.5	100.0	5.5	5.0	100.0	5.0

Tabelë 2. Rritja ekonomike sipas sektorëve të prodhimit për vitet 2005-2006*.

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

*Të dhëna paraprake.


Sektorët që kanë regjistruar ritmet më të larta të rritjes vjetore në tremujorin e tretë të vitit 2006, sipas treguesit të shitjeve, kanë qenë sektori i industrisë, ai i hoteleve dhe restoranteve dhe ai i shërbimeve të tjera. Sektori i ndërtimit dhe ai i telekomunikacionit, kanë regjistruar ritme pozitive rritjeje vjetore në tremujorin e tretë, duke shënuar një rikthim nga normat negative të rritjes së tremujorit të dytë.

	T1 - 06	T2 - 06	T3 - 06	Pesha	Kontributi
Industri	22.9	3.4	19.9	24.5	4.6
Industria nxjerrëse	34.2	5.8	28.4	2.1	0.5
Industria përpunuese	24.3	7.2	26.6	17.4	4.1
Energji elektrike, ujë, gaz	17.7	-7.5	-1.3	5.0	-0.1
Ndërtim	5.8	-1.1	6.8	14.2	1.0
Tregti	17.4	9.5	9.5	44.5	4.3
Hotele, restorante	48.0	33.4	17.4	0.7	0.1
Transport	-2.3	-16.9	-3.7	3.0	-0.1
Telekomunikacion	21.4	-7.2	11.4	7.3	0.8
Shërbime të tjera	31.7	26.3	33.6	5.7	1.6
Ekonomia gjithsej	17.9	5.1	12.4	100	12.4

Tabelë 3. Rritja vjetore e shitjeve të disa sektorëve të ekonomisë³ (në përqindje).

Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve nga ekonomia, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 4. Kontributi i sektorëve në shitjet e ekonomisë (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, tremujori i 2006.

Treguesi i përgjithshëm i shitjeve nga ndërmarrjet ekonomike në tremujorin e tretë të vitit 2006 ka shënuar një rritje vjetore prej 12.4 për qind duke qenë më i lartë se një tremujor më parë, por më i ulët sesa niveli mesatar i rritjes vjetore që nga fillimi i vitit 2005.

Në bazë të ecurisë së disa treguesve të kërkesës së brendshme dhe të investimeve, vlerësohet se kërkesa deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2006 ka qëndruar në nivele të kënaqshme, ndërkohë që investimet, të përafëruara nga importi i makinerive dhe pajisjeve dhe konsumi i dukshëm i çimentos, kanë qenë në nivele të ulëta.

Tabelë 4. Ecuria e disa treguesve të kërkesës së brendshme dhe investimeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006.

Emërtimi	Ndryshimi vjetor (në %)	Ndryshimi tremujor (në %)
Konsumi i karburanteve	57	51
Importi i autovecurave	37	77
Importi i TV	131	36
Importi i makinave larëse	10	27
Importi i makinerive dhe pajisjeve	-15	-11
Konsumi i dukshëm i çimentos	3	19

Burimi: INSTAT, Koniuktura, tremujori i tretë, 2006.

2.2.1 Ecuria e ekonomisë sipas sektorëve

Sektori i industrisë dhe i energjitikës

Aktiviteti i sektorit të industrisë, pas një ngadalësimi në tremujorin e dytë të vitit 2006, u rrit me 20 për qind në tremujorin e tretë të këtij viti, kryesisht si pasojë e rritjes në industrinë përpunuese. Rritja e këtij nënsektori është nxitur nga gjallërimi i aktivitetit të metalurgjisë dhe ai i përpunimit të materialeve në tremujorin e tretë. Kontributi i aktivitetit të industrisë përpunuese në ekonominë e vendit është më i larti, i regjistruar në katër vitet e fundit.

Ecuria e mirë e kësaj industrie është shoqëruar dhe me rritjen e numrit të të punësuarve. Industria nxjerrëse, nga ana tjetër, megjithë rritjen e lartë vjetore në krahasim me tremujorin e kaluar, ka shënuar një kontribut më të ulët në rritjen e përgjithshme vjetore të ekonomisë gjatë tremujorit të tretë. Rritja e shitjeve në nënsektorin e energjisë elektrike, ujit dhe gazit ka ardhur në rënie gjatë vitit 2006, duke kontribuar negativisht me 0.3 pikë përqindjeje në shitjet e ekonomisë të tremujorit të tretë.


Tabelë 5. Treguesit kryesorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh).

	6-M1 '06	Korrik-Nëntor '05	Korrik-Nëntor '06	Ndryshimi vjetor (në %)
I. BURIMET (a+b+c-d)	3,016	2,084	2,274	9.14
a. Prodhimi në vend	3,056	1,759	1,900	8.00
b. Bilanci i shkëmbimit	12	372	404	8.43
c. Prodhim total në shpërndarje	67	38	50	30.24
d. Humbje dhe konsum në transmetim	120	86	79	-7.90
II. PËRDORIMET (e + III)	3,016	2,084	2,274	9.14
e. Konsum i faturuar (f + g)	1,800	1,401	1,462	4.34
f. Konsum familjar	1,111	836	829	-0.81
g. Konsum jofamiljar	689	566	633	11.94
III. HUMBJET (konsum i pafaturar)	1,216	682	812	19.01

Burimi: Bilanci i Energjisë, Korporata Energjitike Shqiptare, 2006.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, prodhimi vendas i energjisë elektrike regjistroi rritje gjatë muajve korrik-nëntor 2006, në ndryshim nga gjashtëmuajori i parë i vitit, në të cilin ai regjistroi një rënie të lehtë. Konsumi i faturuar ka shënuar një rritje vjetore prej rreth 4 për qind, ndërkohë që pjesa më e madhe e kësaj rritjeje i atribuohet rritjes së konsumit me rreth 12 për qind nga ana e konsumatorëve jofamiljarë. Raporti i humbjeve ndaj energjisë së shpërndarë në tremujorin e tretë të vitit 2006 ka qenë më i lartë sesa në tremujorin e tretë të vitit të kaluar, por më i ulët sesa gjatë gjysmës së parë të vitit. Bilanci i shkëmbimit të energjisë për 5 muajt e parë të gjashtëmuajorit të dytë ishte pozitiv dhe më i lartë sesa në gjashtëmuajorin e parë.

Grafik 5. Shitjet në sektorin e ndërtimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve nga ekonomia, Indeksi i kushtimit në ndërtim.


Sektori i Ndërtimit

Shitjet nga sektori i ndërtimit gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006, kanë qenë rreth 4 për qind më të larta sesa ato të së njëjtës periudhë të vitit 2005. Rritja vjetore ka qenë pozitive, por relativisht e ulët në tremujorët e parë dhe të tretë të vitit. Statistikat e shitjeve sugjerojnë se ecuria e këtij sektori është më pak pozitive sesa ajo e parashikuar në fillim të vitit. Shitjet e këtij sektori kanë siguruar vetëm 4 për qind të rritjes së shitjeve të ekonomisë për nëntëmuajorin. Gjithashtu, konsumi i çimentos është rritur me ritme të ngadalta. Përbushja e parashikimit për rritjen e sektorit me 10 për qind do të varet shumë nga ecuria e këtij sektori gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006.

Për sa i përket investimeve të pritshme në këtë sektor sipas statistikave të lejeve të ndërtimit, gjatë 9 muajve të parë të këtij viti vërehet një rënie në bazë vjetore prej 3.6 për qind. Ky tregues është një indikator i mirë i parashikimit të rritjes së këtij sektori në të ardhmen e afërt. Kështu,


vërehet një rënie e ndjeshme e lejeve të ndërtimit për banim me 14 për qind dhe një rritje prej 3.3 për qind, në shumën e planifikuar për infrastrukturë transporti.

Grafik 6. Vlera e parashikuar e investimeve sipas lejes së ndërtimit.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve nga ekonomia, Indeksi i kushtimit në ndërtim.

Grafik 7. Rritja vjetore e shitjeve për sektorët e transportit dhe të telekomunikacionit.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, Tremujori i tretë, 2006.

Shërbime të tjera

Aktiviteti tregtar ka vazhduar t'i japë një shtysë të fortë ecurisë së ekonomisë, duke kontribuar me mesatarisht gjysmën e shitjeve të përgjithshme gjatë vitit 2006. Indeksi i tregtisë, pas një rritjeje të konsiderueshme në gjashtëmuorin e parë të vitit, gjatë tremujorit të tretë është rritur me 9.5 për qind. Ecuria e shitjeve të aktivitetit të hotelerisë dhe bar-restoranteve ka qenë mjaft pozitive edhe për tremujorin e tretë 2006. Sektori i transportit dhe telekomunikacionit, pas një ngadalësimi të aktivitetit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2006, regjistroi rritje vjetore prej 6.5 për qind në tremujorin e tretë. Kjo rritje i atribuohet ecurisë pozitive të sektorit të telekomunikacionit, i cili kontribuoi me 0.83 pikë përqindjeje në rritjen e indeksit të shitjeve, në tremujorin e tretë 2006. Nga ana tjetër, megjithëse gjatë tremujorit të tretë është vërejtur një gjallërim i aktivitetit të transportit, rritja e këtij sektori gjatë vitit 2006 ka qenë më e pakët sesa ajo e regjistruar një vit më parë.

Sektori i bujqësisë

Prodhiminë sektorine bujqësisë gjatë vitit 2006, sipas projeksioneve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pritet të rritet me 2.55 për qind. Mungesa e të dhënave përfundimtare mbi prodhimin vështirëson dhënien e konsideratave mbi ecurinë e këtij sektori. Prodhimi agroindustrial, i cili përfaqëson rreth 20 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, është parashikuar të rritet me rreth 6 për qind, ndërsa ai bujqësor me rreth 1.8 për qind. Nëndega e agroindustrisë ka shënuar zhvillime pozitive gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2006, duke regjistruar një rritje vjetore prej 9 për qind, pavarësisht ngadalësimit të vërejtur në tremujorin e tretë të vitit. Ecuria e prodhimit bujqësor mbetet ende për t'u vlerësuar në muajt e ardhshëm.

Rritja e prodhimit agroindustrial dhe sidomos, e atij të lidhur me përpunimin e frutave dhe zarzavateve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006, ka ndikuar në rritjen e eksporteve të tyre me 54 për qind, në

krahasim me tremujorin e tretë të një viti më parë. Nga ana tjetër, importet e këtij grupi janë rritur vetëm me 15 për qind. Përmirësimi i raportit të eksporteve ndaj importeve bujqësore gjatë tremujorit të tretë të vitit, reflekton rritjen e prodhimit bujqësor vendas në këtë pjesë të vitit.


2.2.2 Tregu i punës

Tregu i punës gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006, konfirmon gjallërimin e aktivitetit ekonomik për këtë periudhë. Zhvillimet pozitive kryesisht në sektorët e tregtisë, të industrisë përpunuese dhe të ndërtimit gjatë tremujorit të tretë, ndihmuan në zbutjen e papunësisë. Rënia në numrin e të papunëve gjatë kësaj periudhe, nuk përputhet plotësisht me rritjen e regjistruar në numrin e të punësuarve. Kjo sugjeron se një pjesë e ofertës për punë është përmbushur jashtë tregut formal të punës.

Struktura e punësimit sipas sektorëve të ekonomisë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2006 është paraqitur e njëjtë me strukturën e vitit paraardhës. Norma e papunësisë ka ardhur në rënie nga tremujori në tremujor, duke shënuar në tremujorin e tretë, normën më të ulët historike prej nëntë vjetësh, prej 13.8 për qind. Në fund të muajit shtator të vitit 2006, forca e punës gjithsej numëronte rreth 2 mijë persona më pak sesa në fund të tremujorit të tretë të vitit 2005. Në të njëjtën kohë, numri i të punësuarve gjithsej është rritur me rreth 3 mijë vetë, ndërkohë që numri i personave të regjistruar si të papunë ka rënë me rreth 5 mijë. Gjatë harkut kohor të një viti, forca e punës së sektorit shtetëror ka rënë me rreth 5 mijë vetë ndërkohë që sektori privat jobujqësor ka regjistruar një rritje të numrit të të punësuarve prej rreth 8 mijë vetësh.


Sipas të dhënave më të fundit nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, në muajin nëntor të vitit 2006 numri i personave të regjistruar si të papunë në zyrat e punës, ka qenë është 149.6 mijë vetë ose 2.8 për qind më i ulët sesa në fund të vitit 2005. Një veçori e dukshme e tregut të punës është fakti që të papunët afatgjatë përfaqësojnë rreth 70 për qind të të gjithë të papunëve në ekonomi.

Grafik 8. Ecuria e prodhimit bujqësor dhe parashikimi për rritjen gjatë vitit 2006



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimi dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Grafik 9. Numri i të papunëve gjatë pesë viteve të fundit (në mijë vetë).



Burimi: INSTAT, Konjuktura, Tremujori i tretë, 2006.

Tabelë 6. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

	2005				2006		
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III
Forca e punës gjithsej	1,087	1,086	1,086	1,086	1,083	1,081	1,084
A. Të punësuar gjithsej	931	931	931	932	931	931	934
i) në sektorin shtetëror	176	176	176	175	174	172	171
ii) në sektorin privat jobujqësor	213	213	214	215	215	217	222
iii) në sektorin privat bujqësor	542	542	542	542	542	542	542
B. Papunësia							
i) të papunë gjithsej	156	155	155	154	152	150	150
ii) norma e papunësisë (%)	14.3	14.3	14.2	14.2	14.0	13.9	13.8

Burimi: INSTAT, Shtator 2006.

2.2.3 Sektori fiskal

Treguesit fiskalë kanë qenë përgjithësisht pranë nivelit të parashikuar në buxhetin suplementar, gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2006. Shmangia më e madhe në treguesit fiskalë vihet re në deficitin buxhetor, si pasojë e mosrealizimit të planit të shpenzimeve. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, gjatë 11 muajve të parë të këtij viti janë mbledhur 97.8 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe janë realizuar rreth 92.6 për qind e shpenzimeve të programuara. Për pasojë, deficitin buxhetor në fund të muajit nëntor ishte rreth 1.5 miliardë lekë nga 13.2 miliardë lekë të parashikuara. Të ardhurat e përgjithshme në periudhën janar – nëntor 2006, arritën nivelin më të lartë në 7 vitet e fundit në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto. Ndërkohë, deficitin buxhetor në raport me po këtë tregues, gjatë viteve të fundit, është karakterizuar nga një trend rënës, i cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2006.

Tabelë 7. Treguesit kryesorë fiskalë në raport me PBB-në (në përqindje).

	11M-99	11M-00	11M-01	11M-02	11M-03	11M-04	11M-05	11M-06
Totali i të ardhurave	20.2	20.7	19.7	21.2	22.0	21.8	21.7	24.4
Të ardhura tatimore	12.6	14.5	13.3	14.8	19.5	19.7	19.6	22.2
Totali i shpenzimeve	29.5	27.7	25.5	26.3	25.8	25.1	23.7	24.5
Shpenzime korente	24.3	22.4	19.8	21.6	22.1	21.2	20.3	20.5
Shpenzime kapitale	5.2	5.1	5.5	4.7	3.7	3.9	3.4	4.0
Deficiti	(9.4)	(6.9)	(5.9)	(5.1)	(3.8)	(3.3)	(2.0)	(0.2)
Financimi i brendshëm	3.8	4.2	3.2	2.2	2.9	2.6	1.4	(0.7)
Financimi i huaj	5.6	2.7	2.6	2.9	0.9	0.7	0.5	0.9

Burimi: Ministria e Financave dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat dhe shpenzimet janë rritur respektivisht me 12 dhe 3.5 për qind. Në muajt e parë të vitit 2006 u vu re një tkurrje e ndjeshme e shpenzimeve. Kjo periudhë u pasua nga një përsheptim gradual i tyre gjatë muajve në vijim. Deficitin buxhetor, deri në muajin nëntor është mbuluar kryesisht me financim të huaj. Ky i fundit u realizua deri në 164 për qind të vlerës së parashikuar.⁴

Tabelë 8. Ritmet e rritjes vjetore së treguesve kryesorë fiskalë (në përqindje).

	11M-00	11M-01	11M-02	11M-03	11M-04	11M-05	11M-06	Mes 99-05
Totali i të ardhurave	14.3	5.7	15.7	12.8	11.3	9.3	12.0	12.1
Të ardhura tatimore	28.8	1.8	19.7	43.2	13.2	9.0	14.4	18.5
Të ardhura nga pushteti lokal	57.9	39.7	32.0	252.1	13.3	16.0	(6.5)	60.7
Të ardhura buxhetore pavarur	10.7	3.3	23.1	11.5	12.7	10.6	10.2	12.4
Të ardhura jotatimore	(26.2)	29.5	(9.3)	(6.6)	(10.4)	(6.7)	(2.1)	(1.5)
Totali i shpenzimeve	4.3	2.7	10.4	6.8	9.1	3.7	3.5	7.5
Shpenzime korente	3.0	(1.9)	17.1	11.5	7.4	5.0	1.3	7.4
Shpenzime kapitale	9.1	21.1	(8.6)	(15.1)	19.9	(3.7)	16.6	10.4
Deficiti	(17.4)	(6.0)	(7.1)	(18.6)	(3.3)	(34.2)	(91.0)	(10.1)
Financim i brendshëm	24.9	(14.7)	(27.7)	43.5	1.3	(39.1)	(148.5)	(3.0)
Financim i huaj	(45.9)	7.5	18.1	(65.3)	(17.8)	(15.6)	68.5	(10.8)

Burimi: Ministria e Financave.


Të ardhurat buxhetore

Gjatë periudhës janar – nëntor të këtij viti, të ardhurat buxhetore ishin rreth 12 për qind më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2005. Niveli i të ardhurave tatimore në fund të muajit nëntor, arriti në rreth 186 miliardë lekë, ndër të cilat tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 12.9 miliardë lekë, duke realizuar nivelin e parashikuar në buxhetin e fillimvitit me respektivisht 99.2 dhe 99.6 për qind. Ndër treguesit kryesorë të të ardhurave tatimore, vihet re se të ardhurat nga buxheti i pavarur janë rritur me 10.2 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke realizuar planin në 103.6 për qind.

Ndërsa të ardhurat nga pushteti lokal dhe ato jotatimore pësuan rënie në krahasim me të njëjtën periudhë, respektivisht me 6.5 dhe 2.1 për qind.

Të ardhurat nga tatimet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave buxhetore, duke përbërë rreth 92 për qind të të ardhurave të përgjithshme. Kontributin kryesor në realizimin e planit të tatimeve e kanë patur të ardhurat nga tatimet mbi fitimin, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga akcizat, të cilat në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë u rritën me përkatësisht 20.4, 14.9 dhe 23.5 për qind. Tatimet mbi të ardhurat personale dhe taksat doganore siguruan përkatësisht 13.9 dhe 6.2 për qind më shumë të ardhura se sa një vit më parë. Për sa i përket të ardhurave jotatimore, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2005 ato pësuan një rënie prej 2.1 për qind, duke realizuar 86 për qind të vlerës së parashikuar për këtë periudhë.

Grafik 10. Struktura e të ardhurave buxhetore (në miliardë lekë).




Burimi: Ministria e Financave, qershor 2006.

Tabelë 9. Treguesit kryesorë të të ardhurave buxhetore (në miliardë lekë – të dhëna progresive).

	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Plani 11M %	Plani vjetor %
Totali i të ardhurave	125.2	143.4	162.3	182.1	202.5	97.8	88.1
Te ardhura tatimore	114.0	131.2	149.2	168.1	186.1	99.2	89.7
Tatimi mbi vlerën e shtuar	39.3	45.7	52.4	59.6	67.1	98.5	88.3
Tatimi mbi fitimin	13.2	14.9	16.7	18.6	20.5	106.0	97.8
Akcizat	11.8	14.2	16.5	18.7	20.9	97.5	86.5
Tatimi mbi të ardhurat personale	4.5	5.2	5.8	6.6	7.3	91.3	81.0
Taksa doganore	8.2	9.3	10.5	11.7	12.9	99.6	91.1
Të ardhura nga pushteti lokal	6.7	7.2	8.1	9.2	9.9	96.7	89.2
Të ardhura nga buxheti i pavarur	22.7	25.9	29.2	32.7	35.5	103.6	95.1
Të ardhura jotatimore	9.3	10.2	11.0	11.8	12.6	85.9	76.1

Burimi: Ministria e Financave, nëntor 2006.

Grafik 11. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave, qershor 2006.

Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore gjatë periudhës janar – nëntor të këtij viti, ishin 203.9 miliardë lekë ose 3.5 për qind më të larta sesa ato të së njëjtës periudhë për vitin 2005. Norma e rritjes së shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë ishte afërsisht sa gjysma e mesatares së rritjes në shtatë vitet e fundit. Shpenzimet e personelit, të cilat përbëjnë rreth 29 për qind të shpenzimeve korente, u realizuan në masën 96 për qind. Shpenzimet korente janë përqendruar në shpenzimet për personelin, për sigurimet shoqërore dhe për buxhetin lokal. Këta zëra kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht në masat 5.2, 7.7 dhe 4.4 për qind.

Shpenzimet kapitale vazhdojnë të realizohen më pak se niveli i planifikuar në buxhetin e rishikuar.

Kështu, për 11 muajt e parë të vitit ato u realizuan në masën 86.9 për qind. Rreth 66 për qind e investimeve kapitale prej 33.4 miliardë lekësh janë realizuar gjatë tre muajve të fundit të periudhës. Për sa i përket financimit të këtyre shpenzimeve, ato të mbuluara me financim të huaj dhe të brendshëm janë realizuar përkatësisht në masën 98.2 dhe 81.7 për qind.

Tabelë 10. Përbërja e shpenzimeve korente (në miliardë lekë).

	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Plani 11M %	Plani vjetor %
TOTALI I SHPENZIMEVE	114	133	152	176	204	92.6	76.4
Shpenzime korente	104	121	137	154	171	94.1	83.5
Personeli	30	35	39	44	49	96.1	83.0
Interesat	15	18	19	21	23	94.3	91.9
Të brendshme	14	16	18	20	22	96.9	94.2
Të huaja	1	1	1	1	2	70.2	70.2
Shpenzime operative mirëmbajtje	11	12	13	15	17	89.6	80.2
Shpenzime për sig. sociale dhe të tjera	33	38	43	48	53	97.2	88.0
Shpenzime për Buxhetin Lokal	9	11	13	15	17	92.2	73.7
Shpenzime të tjera	6	6	7	8	9	82.5	73.6
Shpenzime kapitale	10	11	15	22	33	86.9	58.3
Financim i brendshëm	7	8	11	18	21	81.7	57.8
Financim i jashtëm	3	3	4	5	12	98.2	59.3

Burimi: Ministria e Financave, nëntor 2006.

Bilanci fiskal


Deficiti fiskal gjatë muajve janar – nëntor të këtij viti ishte afërsisht sa 11.8 për qind e deficitit të planifikuar. Ecuria e ngadaltë e shpenzimeve dhe rritja e kënaqshme e të ardhurave, kanë bërë që deficitin të regjistrojë rënie më të lartë në tetë vitet e fundit. Për sa i përket shpërndarjes së deficitit gjatë vitit 2006, vërehet se periodha tetor-nëntor, ka shënuar nivelin më të lartë të deficitit me 11.5 miliardë lekë, ndërsa tremujori i parë rezultoi me një suficit prej 9.2 miliardë lekësh. Kështu, vihet re se deri në muajin tetor, buxheti qeveritar ka rezultuar me një suficit prej 6.2 miliardë lekësh. Gjatë muajit nëntor, kjo situatë ka ardhur drejt përmirësimit, duke sjellë bilancin fiskal për herë të parë gjatë këtij viti në një deficit prej 1.5 miliardë lekësh. Arritja e këtij objekti është shoqëruar me rritjen e shpejtë të shpenzimeve në dy muajt e fundit të vitit, duke vështirësuar blerjen e një deficitit të ri.

2.2.4 Sektori i jashtëm i ekonomisë

Zhvillimet në llogarinë korente deri në tremujorin e tretë të vitit 2006, tregojnë për një aktivitet intensiv të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Vëllimi i transaksioneve në llogarinë korente, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, kapi nivelin 5 miliardë euro, duke qenë 17 për qind më i lartë sesa ai i të njëjtës periudhë për vitin 2005. Deficiti i llogarisë korente gjatë nëntë muajve të parë të vitit, është thelluar me rreth 15 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2005. Thellimi i deficitit në tregtinë e mallrave, si pasojë e rritjes më të lartë të importeve kundrejt rritjes së eksporteve, ka ndikuar në përkeqësimin e bilancit të llogarisë korente. Megjithatë, ndikimi negativ i bilancit të mallrave është kompensuar nga zhvillimet pozitive në gjithë zërat e tjerë të llogarisë korente.


Tremujori i tretë i vitit 2006 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2005, ka shënuar një deficit korent rreth 74 për qind më të lartë. Ndikimin kryesor në përkeqësimin e deficitit korent e ka dhënë zvogëlimi i flukseve hyrëse nga transfertat korente. Llogaria e mallrave, shërbimeve dhe të ardhurave në tremujorin e tretë ka shënuar një deficit pothuajse të njëjtë me atë të regjistruar në tremujorin e tretë të vitit 2006 dhe të barabartë me 375 milionë euro. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, deficiti i tregtisë në mallra është thelluar me rreth 8.5 për qind, deficiti i tregtisë në

Grafik 12. Deficiti mujor buxhetor në vitet 2004, 2005, 2006 (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave, qershor 2006.

Grafik 13. Ecuria e zërave të llogarisë korente, T1:2005 – T3:2006 (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Statistikës.

shërbime është zvogëluar me rreth 60 për qind dhe suficiti i regjistruar në kategorinë e të ardhurave ka qenë rreth 28 për qind më i lartë.

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006 leku ka shfaqur një tendencë të zbehtë rënieje kundrejt shportës me 3 monedha të 5 partnerëve tanë kryesorë tregtarë⁵. Zhvlerësimi është luhatur në nivelin e 1 – 2 për qind. Për rrjedhojë, ndikimi në ecurinë e tregtisë së jashtme vlerësohet të ketë qenë i kufizuar.

Gjatë periudhës janar – shtator 2006, ekonomia e vendit është zhvilluar në mënyrë dinamike. Kjo ecuri është vërejtur edhe në marrëdhëniet e shtuara tregtare me pjesën tjetër të botës. Në fund të muajit shtator, eksportet e mallrave u rritën me 16 për qind, ndërsa importet u rritën me 17 për qind krahasuar me një vit më parë, duke e çuar deficitin e llogarisë së mallrave në rreth 1.2 miliardë euro. Ritmi i lartë i rritjes dhe gama e gjerë e produkteve të importuara, reflektojnë orientimin e tregut të brendshëm drejt prodhimit të huaj.

Grupmallrat më të kërkuar nga tregu i brendshëm janë të lidhur si me konsumin final, grupet e ushqimeve, konsumin e ndërmjetëm, produktet minerale, ato të industrisë kimike, plastike, materiale bazë, si dhe me grupin e makinerive dhe paisjeve, që reflektojnë ecurinë e investimeve kapitale në ekonomi. Importi i artikujve tekstilë dhe i atyre të lëkurës, që është i lidhur me ecurinë e prodhimit për riekспорт, është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Ky zhvillim është reflektuar në rritjen e vazhduar të eksporteve me mallin e porositësit. Për t'u veçuar janë gjithashtu edhe zhvillimet pozitive në grupin e produkteve vegetale dhe ushqimeve të përgatitura, sidomos gjatë tremujorit të tretë. Ky grup ka regjistruar jo vetëm ulje në normën e rritjes së importit, por edhe rritje të eksporteve me rreth 20 për qind, gjatë periudhës kur prodhimi bujqësor vendas shënon nivelet më të larta. Rritje e qëndrueshme është regjistruar edhe në eksportet e produkteve minerale dhe të metaleve bazë.


Viti 2006 nuk ka shënuar ndryshime të dukshme në strukturën e shpërndarjes së importeve dhe të eksporteve të mallrave sipas shteteve të origjinës dhe atyre të destinacionit. Vendet e Bashkimit Evropian vazhdojnë të përbëjnë grupin më të rëndësishëm të partnerëve tregtarë. Krahas Italisë dhe Greqisë, partnerë të tjerë të rëndësishëm tregtarë janë edhe Turqia, Ukraina, Rusia, Kina dhe Koreja e Jugut. Tregtia me vendet e rajonit gjatë kësaj periudhe zë rreth 8 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tregtisë së mallrave.

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006 zhvillimet në bilancin e shërbimeve konsiderohen si të kënaqshme, pasi kanë ndikuar pozitivisht në zbutjen e deficitit të llogarisë korente. Si eksportet, ashtu edhe importet e shërbimeve, janë rritur me norma të larta. Në fund të periudhës, deficitin e tregtisë së shërbimeve ishte rreth 64 milionë euro ose 26 për qind më i ulët sesa ai i nëntëmujorit të parë

të vitit të kaluar. Ritmi më i lartë i rritjes së eksporteve të shërbimeve të transportit dhe të shërbimeve të tjera në krahasim me rritjen e importeve, ka dhënë ndikimin kryesor në zbutjen e deficitit të kësaj llogarie. Një nga zërat kryesorë të llogarisë së shërbimeve është zëri i “udhëtimeve personale”, i cili në një masë të madhe paraqet ecurinë e turizmit brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat tregojnë për një ngadalësim të aktivitetit të turizmit për vitin 2006 në vend. Gjatë periudhës korrik – shtator, periudha kryesore e turizmit në vendin tonë, jorezidentët kanë shpenzuar rreth 221 milionë euro apo rreth 12 për qind më shumë se një vit më parë. Rezidentët, për të njëjtën periudhë kanë paguar një faturë prej 216 milionë eurosh për turizëm jashtë vendit ose 20 për qind më shumë se sa një vit më parë.

Llogaria e të ardhurave korente ka vazhduar të regjistrojë bilanc pozitiv edhe gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2006. Në muajin shtator kjo llogari shënoi një suficit prej rreth 159 milionë eurosh ose rreth 73 për qind më të lartë se një vit më parë. Rritja e të ardhurave ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve sezonalë, si dhe nga rritja në interesat nga investimet e portofolit dhe ato të rezervës valutore. Në muajin shtator, suficiti i llogarisë së transfertave korente shënoi 690 milionë euro, duke qenë rreth 4 për qind më i lartë sesa fluksi neto i transfertave gjatë të njëjtës periudhë një vit më parë. Zëri kryesor i kësaj llogarie, ai i dërgesave nga emigrantët, u rrit me 17 për qind duke arritur nivelin 683 milionë euro. Rënia e dërgesave gjatë tremujorit të tretë të vitit mund të jetë një dukuri e përkohshme. Dërgesat e emigrantëve kanë mbuluar rreth 54 për qind të deficitit tregtar të mallrave dhe shërbimeve.

Grafik 14. Bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve, T1: 2005 – T3: 2006 (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Statistikës.

Tabelë 11. Zërat kryesorë të llogarisë korente (në milionë euro).

	Korrik	Gusht	Shtator	T3-06	T3-05	9M-06	9M-05
Llogaria korente	- 30.2	- 28.6	- 70.7	-129.4	-76.8	-410.6	-355.5
Mallra, shërbime dhe të ardhura	-110.9	- 109.3	- 150.8	-371.0	-377.3	-1100.0	-1017.9
Mallra	- 133.5	- 143.5	- 138.2	-415.3	-382.3	-1200.0	-1022.7
Eksporte	59.3	37.0	56.9	153.2	133.7	463.3	398.5
Importe	- 192.8	- 180.5	- 195.2	-568.5	-516.1	-1663.2	-1421.3
Shërbime	- 1.1	17.5	- 31.4	-15.1	-39.0	-60.7	-87.0
Eksporte	112.3	135.5	89.1	337.0	270.8	895.5	714.1
Importe	-113.5	-118.1	-120.5	-352.0	-309.9	-956.2	-801.1
Të ardhura	23.7	16.7	18.9	56.3	44.1	158.5	91.8
Transferta korente	80.8	80.7	80.1	241.6	300.5	689.5	662.4
Remitanca	79.2	79.2	79.2	237.7	259.5	689.5	582.6

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Statistikës.

3. ECURIA E INFLACIONIT


Norma vjetore e inflacionit në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006 është luhatur rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3 për qind. Inflacioni arriti vlerën 2.5 për qind në muajin dhjetor, duke qenë 0.5 pikë përqindjeje më i lartë se në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Norma mesatare prej 2.4 për qind e inflacionit vjetor gjatë vitit 2006 ishte e njëjtë me normën mesatare të vitit 2005, gjë që flet për qëndrueshmëri të inflacionit në periudha më të gjata se një vit.

Dinamika e ecurisë së inflacionit mujor për periudhën korrik-dhjetor të vitit 2006 është në përputhje me sjelljen historike të viteve të fundit. Ndryshimet mujore të inflacionit gjatë gjashtëmuajorit të dytë përgjithësisht, shfaqin një tendencë rritjeje duke kulmuar në muajt dhjetor, me rritjen spekulative të çmimeve gjatë festave të fundvitit. Ky fenomen, në fund të vitit 2006 u shfaq në një masë të moderuar dhe të krahasueshme me atë të dy viteve të mëparshme. Inflacioni mujor prej 1.7 për qind i regjistruar në muajin dhjetor të vitit 2006, ishte më i ulëti në katër vitet e fundit.

Tabelë 12. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6	1.5
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	2.4
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8	3.2
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.9
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	2.6
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	2.3
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	2.9
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.4	2.4

Burimi: IÇK, INSTAT, 2006.



Zhvillimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006 ndodhën brenda një kuadri të ekuilibruar makroekonomik, në të cilin presionet inflacioniste, megjithëse të pranishme, kanë qenë nën kontroll. Politika monetare dhe fiskale kanë kontrolluar presionet nga ana e kërkesës dhe e ofertës në ekonomi, duke mundur respektimin e objektivit të inflacionit. Inflacioni vjetor gjatë kësaj periudhe nuk i ka kaluar asnjëherë kufijtë e tolerancës prej 1 pikë përqindjeje rreth objektivit prej 3.0 për qind.


3.1 ECURIA E INFLACIONIT SIPAS GRUPEVE KRYESORE

Ecuria e inflacionit gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006 u ndikua nga veprimi i një sërë faktorësh, si: rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin gusht, shmangia nga korniza sezonale e prodhimit të brendshëm bujqësor, rritja në çmimet e disa mallrave të akcizës, si dhe ecuria e çmimit të naftës. Midis faktorëve të lartpërmendur, grupet “Ushqime dhe pije joalkolike”, “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” dhe “Pije alkolike dhe duhan” kanë qenë grupet kryesore, që përcaktuan normën e inflacionit gjatë kësaj periudhe.

Çmimet e mallrave ushqimorë gjatë këtij gjashtëmujori, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin dhe ecurinë e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Inflacioni vjetor i këtij grupi ka kontribuar mesatarisht me 0.3 pikë përqindjeje në inflacionin e përgjithshëm të kësaj periudhe. Gjatë kësaj periudhe, presionet në kahun rritës nga ana e këtij grupi kanë qenë mjaft më të larta sesa ato të vitit të kaluar dhe të vitit 2004, kur kontributi i këtij grupi në normën e përgjithshme të inflacionit ka qenë përkatësisht 0.0 dhe -0.6 pikë përqindjeje. Një gërshetim faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm kanë kushtëzuar ndryshimin e kahut të kontributit të këtij grupi. Kushtet jo të favorshme atmosferike gjatë stinës së pranverës kanë pasur efekt negativ në ofertën e prodhimit bujqësor, duke nxitur hyrjen në tregun e brendshëm të mallrave të importit me çmime të larta. Normat pozitive të inflacionit vjetor të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” gjatë pjesës më të madhe të vitit reflektojnë praninë dhe peshën e mallrave të importit. Përjashtim bëjnë muajt shtator-tetor, gjatë të cilëve prodhimi i brendshëm bujqësor mund të ketë përballuar më mirë kërkesën në vend për produkte bujqësore, duke bërë që inflacioni vjetor i grupit në këta muaj të ishte negativ. Efekti sezonal, edhe pse i vonuar dhe i shkurtër, u pasqyrua në normat mujore të inflacionit. Në përputhje me sjelljen sezonale, inflacioni mujor i grupit ushqimor dhe inflacioni i përgjithshëm shënuan norma negative gjatë periudhës maj – gusht.


Çmimet e mallrave ushqimorë u ndikuan gjithashtu nga tendenca rritëse e çmimeve të këtyre mallrave në tregjet evropiane. Sjellja e favorshme e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros, zbuti ndikimin e çmimeve të huaja deri

Grafik 16. Kontributi i shportës së IÇK-së në grupet kryesore (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 17. Kontributi i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” në inflacionin mujor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

në muajin qershor, por nuk arriti të kompensonte rritjen e çmimeve të mallrave ushqimorë gjatë gjashtëmuajorit të dytë të këtij viti. Në këtë periudhë, leku u nënçmua mesatarisht me 0.4 për qind ndaj euros, në krahasim me mbiçmimin prej 2.4 për qind dhe 2.2 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe gjashtëmuajorit të parë të këtij viti.

Tabelë 13. Inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i këtij grupi në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'06	Kontributi (pp)	Itali ⁶ Inflacioni vjetor'06	Greqi ⁷ Inflacioni vjetor'06	Eurozona ⁸ (12 vende)
Mars	-1.7	-0.7	0.4	0.2	1.0	2.8	1.3
Qershor	1.6	0.7	1.9	0.8	1.3	3.0	2.0
Korrik	-1.6	-0.7	4.7	1.9	1.8	5.4	2.6
Gusht	0.0	0.0	1.3	0.5	2.2	4.6	2.9
Shtator	1.5	0.6	-1.1	-0.5	2.5	4.6	3.3
Tetor	1.7	0.7	-1.5	-0.6	2.7	5.1	3.0
Nëntor	0.2	0.1	1.1	0.5	2.9	4.5	3.0*
Dhjetor	-1.9	-0.8	0.2	0.1	2.7	4.3	--

Burimi: Banka e Shqipërisë; Sekretariati i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar Statistikor të Greqisë; ISTAT-Itali.

(*) Vlera paraprake.

Grupi me ndikimin më të madh në formimin e normës vjetore të inflacionit edhe gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006, ishte grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji". Kontributi mesatar i këtij grupi në normën vjetore të inflacionit për periudhën në fjalë, ishte 1.8 pikë përqindjeje. Pas shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të energjisë elektrike në fillim të këtij viti, normat vjetore të inflacionit të këtij grupi u rritën në mënyrë modeste deri në muajin gusht, kur çmimi i energjisë elektrike u rrit me 13.7 për qind në terma vjetorë. Norma pozitive rritjeje shënuan të gjitha elementet përbërëse të këtij grupi. Krahas rritjes së çmimit të energjisë elektrike, rritje u regjistrua edhe në çmimet e tregut të qirasë dhe rentës së imputuar. Normat më të larta vjetore të inflacionit të këtij grupi gjatë këtij gjashtëmuajori, u regjistruan përkatësisht në muajt shtator (8.5 për qind) dhe tetor (8.0 për qind), duke reflektuar rritjen e kërkesës për shtëpi në kohën e fillimit të vitit shkollor.

Tabelë 14. Norma vjetore e inflacionit total dhe e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" si dhe kontributi i tij dhe i nëngrupeve në inflacionin total.


	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Inflacioni total vjetor (në %)	1.5	2.5	3.2	2.9	2.6	2.3	2.9	2.5
Inflacioni i grupit (në %)	3.2	3.9	3.2	6.5	8.5	8.0	7.0	7.0
Kontributi në inflacionin total (në pikë përqindjeje)								
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	0.9	1.0	0.9	1.8	2.3	2.2	1.9	1.9
Qira	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Renta e imputuar	0.7	0.9	0.8	0.8	1.2	1.1	0.9	0.9
Lëndë djegëse, energji	0.0	0.0	0.0	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, 2006.

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në gjashtëmuajorin e dytë u ndikua në mënyrë të ndjeshme nga inflacioni i grupit "Pije alkolike dhe duhan". Informacioni për rritjen e akzicës për çmimet e këtyre mallrave u pasqyrua

në çmimet e tyre të shitjes, që në muajin gusht, duke i paraprirë hyrjes në fuqi të këtij vendimi në muajin shtator. Ky veprim pasqyron natyrën spekulative të tregut të brendshëm. Pavarësisht peshës së vogël prej 3.1 për qind të grupit “Pije alkolike dhe duhan” në shportën e mallrave të konsumit, ai kontribuoi mesatarisht në normën vjetore të inflacionit për këtë periudhë me 0.3 pikë përqindjeje ose në të njëjtën masë si grupi “Ushqime dhe pije joalkolike”.

Gjashtëmuaji i dytë i vitit 2006 u karakterizua nga rritje në bazë vjetore të ulëta në inflacionin e grupeve “Transport” dhe “Hotele, restorante e kafene”. Kontributi mesatar i këtyre grupeve në inflacionin vjetor të kësaj periudhe ishte 0.1 pikë përqindje dhe 0.2 pikë përqindje përkatësisht. Ritmet e ulëta të rritjes së inflacionit në grupin “Transport” u udhëhoqën kryesisht nga rritja e moderuar e çmimit të naftës. Gjatë këtij gjashtëmuaji, çmimi i naftës në vend u rrit mesatarisht me 0.1 për qind në terma vjetor. Kjo rritje ishte më e ulët sesa rritja prej 0.3 për qind e regjistruar si në gjashtëmuajin e parë të këtij viti, ashtu dhe në gjashtëmuajin e dytë të vitit të kaluar. Zhvillimet pozitive në çmimin e naftës në tregjet botërore, krahas mbiçmimit më të theksuar të monedhës vendase ndaj dollarit amerikan gjatë kësaj periudhe, nxitën rënien e çmimit të këtij produkti në vend.



Çmimet e mallrave të grupeve të tjera të shportës kanë shfaqur prirje të ndryshme gjatë gjashtëmuajit të dytë të vitit. Kontributi i kombinuar i inflacionit të tyre ka qenë pothuajse i pandjeshëm, pasi grupet me kontribut pozitiv janë balancuar nga ato me kontribut negativ. Rënia e çmimeve të mallrave të tregtueshëm, që bëjnë pjesë në grupet “Veshje dhe këpucë”, “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” është një fenomen afatgjatë, që ka filluar të paktën që prej vitit 2000. Kontributi rënës i tyre është kompensuar nga rritja e çmimeve të shërbimeve që bëjnë pjesë në grupet “Shërbimi shëndetësor” dhe “Shërbimi arsimor”.

3.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Zhvillimet makroekonomike në vend në gjysmën e dytë të vitit 2006, kanë krijuar një ambient përgjithësisht të favorshëm për kontrollin e normës së inflacionit. Presionet inflacioniste kanë ardhur kryesisht nga kahu i ofertës. Këto presione, në momente të caktuara, u shprehën me intensitet të lartë. Ndër to, më të evidentuarit ishin rritja e çmimit të energjisë elektrike gjatë muajit gusht, rritja e çmimit të mallrave të akcizës si edhe rritja e çmimit të naftës deri në muajin tetor të këtij

viti. Në këto kushte, reagimi i politikës monetare në kahun shtrëngues, në mesin e muajit korrik dhe në fund të muajit nëntor, vlerësohet të ketë filluar të frenojë tendencën rritëse të presioneve inflacioniste në ekonomi. Në mënyrë të veçantë, zbutja e këtyre presioneve, u vërejt gjatë muajit të fundit të vitit, i cili historikisht është perceptuar si një muaj me inflacion të lartë. Në këtë drejtim vlerësohet të kenë ndihmuar pozita e qëndrueshme e lekut në tregun e këmbimeve valutore, mungesa e presioneve inflacioniste nga ambienti i jashtëm dhe rënia e çmimit të naftës në tregun vendas gjatë kësaj periudhe. Shpenzimet buxhetore dhe deficitit buxhetor, pavarësisht nga fakti se janë përqendruar në periudhën e fundit të vitit, kanë qenë në nivele të kontrolluara. Kjo ka ndihmuar që kërkesa agregate të mbetet brenda parashikimeve, duke mos përcjellë presione inflacioniste në ekonomi. Megjithatë, një pjesë e impaktit në kërkesë dhe në inflacion do të mbartet në tremujorin e parë të vitit 2007.

FAKTORË TË KËRKESËS


Treguesit e kërkesës së brendshme

Sinjalet që vijnë nga treguesit e ndryshëm flasin për një rritje të kërkesës së brendshme gjatë gjysmës së dytë të vitit. Kështu, treguesi i shitjeve për nëntëmuajorin e parë të vitit shënoi një rritje vjetore prej 12.4 për qind. Treguesit e tregtisë së jashtme, po për këtë periudhë, dëshmojnë për rritje të eksporteve dhe importeve, përkatësisht me 16 dhe 17 për qind krahasuar me një vit më parë. Këta tregues, së bashku me rritjen e shpejtë të aktivitetit kreditues, flasin për një zgjerim të konsumit dhe të investimeve. Megjithatë kjo rritje e kërkesës së brendshme, nisur nga dinamika e treguesve të inflacionit, nuk ka qenë e mjaftueshme për të përcjellë presione inflacioniste në ekonomi.

Politika fiskale

Në përgjithësi, financimi i deficitit buxhetor nëpërmjet huamarrjes së brendshme ka qenë i ulët gjatë pjesës së dytë të vitit. Kërkesa e qeverisë për mjete monetare nuk ka ushtruar presion për zgjerimin e burimeve monetare. Treguesit fiskalë nuk kanë tejkaluar vlerat e programuara për këtë periudhë, edhe në kushtet e shifrave të rishikuara. Në këtë aspekt, politika fiskale nuk ka cënuar ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë.

Nga ana tjetër, të dhënat e muajit nëntor, tregojnë për një përqendrim të shpenzimeve buxhetore në fundin e vitit. Megjithë rritjen e përshpejtuar të ritmit të kryerjes së shpenzimeve, përsëri ato kanë mbetur prapa planit. Përqendrimi




i shpenzimeve gjatë tremujorit të katërt, ka rritur mundësinë e gjenerimit të presioneve inflacioniste për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Politika dhe kushtet monetare

Në kushtet kur presionet inflacioniste nga ana e ofertës u shfaqën në mënyrë më intensive në pjesën e dytë të vitit, politika monetare akomodoi këto zhvillime duke zbatuar një politikë shtrënguese. Rritja e normës bazë të interesit synoi krijimin e kushteve të përshtatshme monetare për kontrollin e këtyre presioneve. Oferta e parasë shënoi një rritje graduale, duke plotësuar kërkesën në rritje si të sektorit publik ashtu edhe të atij privat. Banka e Shqipërisë ka vijuar të jetë e pranishme në tregjet e parasë, duke synuar të sigurojë likuiditetin e duhur dhe të minimizojë luhatjet e normës së interesit. Nga ana tjetër, raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, është luhatur në vlerat më të ulëta historike. Plotësimi i kërkesës së likuiditetit së tregut dhe ruajtja e niveleve të ulëta të parasë jashtë bankave, i ka shërbyer ruajtjes së stabilitetit të çmimeve gjatë periudhës afatmesme.

Grafik 20. Treguesit kryesorë monetarë.



FAKTORË TË OFERTËS

Ambienti i jashtëm dhe kursi i këmbimit

Zhvillimet në kursin e këmbimit kanë ndihmuar zbutjen e presioneve inflacioniste, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006. Monedha vendase është mbiçmuar dukshëm ndaj dollarit dhe ka qëndruar në nivele të qëndrueshme në lidhje me euron. Një ecuri e tillë e kursit të këmbimit, vlerësohet të ketë qenë një ndër faktorët kryesorë që ka frenuar presionet e forta nga ana e ofertës dhe ka ndikuar në ruajtjen e një norme të inflacionit brenda vlerave të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Kjo sepse, nga njëra anë ka ndihmuar uljen e kostos së mallrave të importit dhe nga ana tjetër, ka siguruar një status quo të çmimit të naftës në vend, ndërkohë që në tregun botëror ky çmim njohu rritje (në mënyrë të veçantë në tremujorin e tretë të këtij viti).

	T1*-06*	T2*-06*	T3*-06*	T4*-06*
Greqi ⁹	3.2	3.2	3.4	2.9
Itali ¹⁰	2.2	2.2	2.2	1.8
Eurozonë ¹¹	2.3	2.4	2.1	1.8
Lek/Euro	-2.9	-1.4	0.1	0.7
Lek/Usd	5.7	0.1	-4.1	-7.0

Burimi: IÇK, INSTAT.

Shënime: (*) Shifrat për tremujorët janë mesatare e treguesve përkatës mujorë.

Tabelë 15. Normat vjetore të inflacionit të Italisë, Greqisë, Eurozonës dhe ndryshimi vjetor i kurseve të këmbimit (në përqindje).

Inflacioni i importuar

Ecuria e çmimeve të konsumit në partnerët tregtarë të Shqipërisë, ka qenë një faktor ndihmues në përcjelljen e tendencave në rënie tek çmimet e konsumit në vend. Norma e inflacionit në dy vendet partnere kryesore të tregtisë, Greqi dhe Itali, por edhe në vendet e tjera të Eurozonës, ka shënuar vlera dukshëm më të ulëta në fundin e vitit 2006, krahasuar me një vit më parë, si rezultat i rënies së çmimit të naftës. Ndërkohë, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkolike”, u zbutën nga futja e vonë në treg e prodhimit vendas gjatë fundit të muajve të verës së vitit 2006.

Çmimet e naftës dhe situata energjitike

Prirja rënëse e çmimeve të naftës që filloi në muajin tetor nxiti rënie e çmimeve në tregun vendas. Si rezultat, rreziku i paralajmëruar për

presione inflacioniste të nxitura nga rritja e çmimit të naftës, gjatë muajve të verës dhe në pjesën e parë të gjashtëmuajorit të dytë, nuk u materializua. Nga ana tjetër, efektet e çmimit të naftës në tregun vendas përforcohen edhe nga situata e furnizimit me energji, e cila duke filluar nga muaji dhjetor filloi të shfaqej si problematike. Pasojat e bashkëveprimit të këtyre dy faktorëve, si dhe efektet e raundit të dytë që mund të shkaktojnë tek çmimet, vazhdojnë të mbeten në vëmendje të politikës monetare.


Prodhimi bujqësor

Lëkundjet në çmimet e mallrave dhe shërbimeve të grupeve kryesore të shportës së konsumit, kanë kompensuar njëri-tjetrin, duke e mbajtur normën e inflacionit poshtë objektivit prej 3 përqind, por brenda kufirit të tolerancës. Kështu, rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin gusht, rritja e çmimeve të mallrave të akcizës dhe atyre të shërbimit arsimor kontribuan në rritjen me 1 pikë përqindjeje të inflacionit total. Nga ana tjetër, sjellja e favorshme e çmimeve të grupit ushqimor, deri në fund të vitit 2006, ka balancuar vlerat e larta të inflacionit të mallrave dhe shërbimeve të veçanta. Rënia në çmimet e mallrave të këtij grupi u favorizua nga kushtet e përshtatshme klimaterike dhe rritja e prodhimit bujqësor, duke e shtrirë efektin sezonal rënës tek çmimet në përgjithësi, pothuajse deri në fundin e vitit.

Papunësia dhe pagat


Situata në tregun e punës ka vazhduar të përmirësohet, ndërkohë që pagat në sektorin

Grafik 21. Norma vjetore e ndryshimit të IÇK-së dhe indeksit të çmimeve të importit (në përqindje).



Burimi: IÇK, INSTAT, janar 2007; Banka e Shqipërisë, janar 2007.

Grafik 22. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës (majtas, në lekë/usd) dhe i kursit të këmbimit (djathtas, në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Bloomberg, dhjetor, 2006.

shtetëror, paga minimale dhe pensionet kanë pësuar rritje sipas programit të buxhetit. Këto elemente nuk kanë përcjellë presione të forta inflacioniste në ekonomi, gjatë periudhës korrik- dhjetor 2006, madje as në periudhën e fundvitit, kur kërkesa për mallra dhe shërbime rritet së tepërmi.

4. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE


4.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Ambienti i përgjithshëm ekonomik dhe ai financiar shtruan disa sfida të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006. Presionet inflacioniste ishin në rritje gjatë kësaj periudhe, kryesisht nën veprimin e faktorëve të ofertës. Mundësia e përcjelljes së çmimeve të larta të naftës në kostot e prodhimit dhe faktorizimi i tyre në pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë është monitoruar në vazhdimësi nga Banka e Shqipërisë, duke synuar një reagim të shpejtë dhe të plotë ndaj tij. Nga ana tjetër, rritja e shpejtë e kredisë për ekonominë dhe përqendrimi i shpenzimeve buxhetore në tremujorin e fundit të vitit, sugjeruan se tabloja e presioneve inflacioniste ishte më e plotë, duke përfshirë në të edhe faktorët e kërkesës. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë reagoi nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit në muajt korrik dhe nëntor. Këto lëvizje e rritën nga 5.0 për qind në 5.5 për qind normën bazë të interesit, gjatë gjashtëmuajorit të dytë.

Shtrenjtimi i kostos së parasë synoi ruajtjen e kushteve monetare të përshtatshme për garantimin e stabilitetit të çmimeve, në një periudhë afatgjatë. Shtrëngimi i kushteve monetare është në linjë me politikën monetare të ndjekur nga bankat e mëdha qendrore dhe rritjen e normave të interesit në tregjet valutore ndërkombëtare. Kjo lëvizje e Bankës së Shqipërisë është reflektuar në normat e interesit të tregjeve monetare.

Nga ana tjetër, rritja e huamarrjes së qeverisë dhe ruajtja e ritmeve të larta të kreditimit në lekë kanë krijuar mungesa likuiditeti në sistem gjatë tremujorit të fundit të vitit. Kjo situatë u reflektua në rritjen e *yield*-eve të bonove të thesarit dhe në një luhatshmëri më të lartë të tregut ndërbankar. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka hedhur likuiditet në sistem, duke synuar uljen e luhatjeve të normave të interesit dhe plotësimin e kërkesës afatshkurtër të tregut për likuiditet. Injektimi i likuiditetit në sistem është kryer nëpërmjet instrumentit të repove të anasjellta, duke arritur në vlerën 6.5 miliardë lekë në fund të vitit 2006.

Grafik 23. Ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ky injektim ndikoi në zbutjen e presioneve mbi *yield*-in e bonove të thesarit. Paralelisht me operacionet në tregun e parasë, ndërhyrjet në tregun valutor kanë ndihmuar në plotësimin e kërkesës së ekonomisë për para likuide dhe në respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 16. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë¹².

	Dhjetor '05	Mars '06	Qershor '06	Shtator '06	Nëntor '06	Dhjetor '06 *
Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë (në milionë dollarë)						
Objektivi	1,172	1,117	1,112	1,252	1,262	1,268
Aktuale	1,172	1,202	1,224	1,296	1,305	1,334
Diferenca (A-Obj)	--	85	112	44	43	66
Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (në miliardë lekë)						
Objektivi	82.0	85.0	90.0	82.9	85.6	86.9
Aktuale	76.9	61.9	67.8	71.2	72.7	79.5
Diferenca (A-Obj)	-5.1	-23.1	-22.2	-11.7	12.9	7.4
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)						
Objektivi	317.8	325.8	329.8	335.8	340	341.8
Aktuale	317.8	311.8	306.6	307.4	312	--
Diferenca (A-Obj)	--	-14.0	-23.3	-28.5	-28	--

*Të dhëna operative.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Zhvillimet monetare në gjashtëmuorin e dytë të vitit kanë vijuar të pasqyrojnë kryesisht dinamizmin e vërejtur në aktivitetin ekonomik të sektorit privat, megjithë rritjen graduale të kërkesës së qeverisë për mjete monetare. Kreditimi i ekonomisë mbetet kontribuesi kryesor i rritjes së mjeteve monetare në ekonomi. Gjithashtu, prurjet valutore nga remitancat kanë kontribuar pozitivisht në rritjen sezonale të depozitave në valutë dhe të mjeteve valutore neto të sistemit. Rritja e kërkesës së qeverisë për financim, veçanërisht gjatë tremujorit të fundit, ndikoi në një ekspansion më të shpejtë monetar në krahasim me gjashtëmuorin e parë. Oferta monetare shënoi një rritje vjetore me 12.7 për qind në muajin nëntor, kundrejt një rritjeje prej 9.7 për qind në muajin qershor.


Megjithatë, kërkesa relativisht e ulët e sektorit publik gjatë vitit 2006 ka kontribuar në uljen e ritmeve të rritjes monetare kundrejt dy viteve të mëparshme. Ritmet aktuale të zgjerimit vjetor të agregatëve monetarë, rezultojnë dukshëm më të ulëta kundrejt ritmeve prej 17-18 për qind të dy viteve të fundit. Gjithashtu, ngadalësimi i ritmit të rritjes së kredidhënies është një premisë tjetër për një ekspansion më të ngadalhtë monetar dhe për ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë. Pakësimi gradual i peshës së parasë në qarkullim tenton të favorizojë qarkullim më të shpejtë të parasë dhe monetizim të ekonomisë në linjë me tendencat e vërejtura në ekonomitë më të zhvilluara.

Krijimi i parasë në ekonomi ka gjetur pasqyrim të dukshëm në rritjen e nivelit të depozitave, ndërsa pesha e parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare ka shfaqur tendencë rënëse. Kështu, raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit monetar M2 zbriti në nivelin 32.5 për qind në muajin nëntor, kundrejt 32.9 për qind në fund të muajit qershor. Gjithashtu, niveli i lartë i depozitave në valutë ka thelluar uljen e peshës së parasë jashtë bankave ndaj parasë së gjerë M3 me rreth 0.8 pikë përqindjeje, gjatë periudhës korrik-nëntor 2006. Kjo ecuri është në linjë me tendencën pozitive të zhvillimit të sistemit bankar. Ulja e përdorimit të parasë fizike në ekonomi, krijon kushte për zbutje të kostos së ndërmjetësimit financiar në ekonomi.

Depozitat në sistemin bankar shënuan një rritje vjetore prej 15.3 për qind në muajin nëntor, kundrejt rritjes prej 11.7 për qind në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit. Përgjithësisht, hyrjet në lekë janë kanalizuar në depozita me afat ndërsa prurjet në valutë, kryesisht pjesa e sektorit privat, kanë marrë formën e depozitave me afat ndaj atyre pa afat është reflektuar në raportin e depozitave me afat ndaj M3. Ky tregues shënoi vlerën 54.1 për qind në muajin nëntor ose 0.7 pikë përqindjeje më shumë se në muajin qershor dhe 1.9 pikë përqindjeje më shumë se një vit më parë. Niveli i depozitave në valutë ruan ritmet më larta të rritjes kundrejt rritjes vjetore të depozitave në lekë. Depozitat në lekë janë rritur me 5.5 për qind në krahasim me muajin qershor ndërsa ato në valutë janë rritur me 13.6 për qind. Në këto kushte, struktura valutore e parasë së gjerë ka ruajtur tendencën e zhvendosjes drejt depozitave në lekë e në valutë, përkundrejt uljes së peshës së parasë jashtë bankave.


Krijimi i parasë në formën e depozitave në valutë është favorizuar nga ritmet e larta të huamarrjes së sektorit privat në monedhë të huaj dhe nga normat në rritje të interesave në euro dhe usd. Një faktor me ndikim të rëndësishëm në tendencën rritëse të tyre ka qenë rritja e normave të interesit nga Banka Qendrore Evropiane dhe Rezerva Federale. Kjo rritje ka

Grafik 24. Kontributi i faktorëve të kërkesës ndaj rritjes vjetore të M3 (në miliardë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Rritja vjetore e M3, dhe përbërësve të saj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Pësia e parasë jashtë bankave dhe e depozitave në valutë ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

çuar në ngushtimin e diferencave midis normave të depozitave me afat në lekë dhe atyre në valutë. Megjithatë, rritja e normës bazë të interesit të lekut ka kontribuar në ruajtjen e diferencave pozitive midis interesave në lekë dhe atyre në valutë.

Tabelë 17. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë).

	Nëntor	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2006	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	146.3	0.5	0.3	6.6	4.8
Depozita totale	491.7	2.2	0.5	65.4	15.3
- në lekë	303.3	3.2	1.1	29.4	10.7
- në valutë	188.4	-1.0	-0.5	36.0	23.6
M1	226.9	1.3	0.6	11.2	5.2
M2	449.6	3.7	0.8	36.0	8.7
M3	638.0	2.7	0.4	72.0	12.7
Baza monetare	209.3	3.6	1.7	20.4	10.8
Peshat ndaj parasë së gjerë (në përqindje)					
	Dhjetor '05	Qershor '06		Nëntor '06	
Para jashtë bankave /M3	25.9	23.7		22.9	
Depozita në lekë /M3	47.8	48.4		47.5	
Depozita në valutë /M3	26.3	27.9		29.5	

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3 KËRKESA PËR MJETE MONETARE

4.3.1 Kredia për ekonominë

Kredia për ekonominë ka vijuar të shënojë ritme të shpejta rritjeje edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006. Portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë arriti në 179.5 miliardë lekë në muajin nëntor 2006, duke përbërë 28.1 për qind të mjeteve monetare të ekonomisë. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto ajo ndodhet në nivelet e saj më të larta historike, në 20.1 për qind. Megjithatë, ritmi i zgjerimit vjetor të kredisë për ekonominë ka shënuar rënie gjatë këtij gashhtëmujori, duke zbritur nga niveli 67.1 për qind në muajin qershor në 57.8 për qind në muajin nëntor. Ngadalësimi i ritmit të rritjes është rezultante e nivelit të lartë të kreditimit për një periudhë 2-vjeçare. Gjithashtu, segmentet e reja të tregut të pambuluara me kredi kanë ardhur në rënie, duke mos mundur më ruajtjen e ritmeve të tilla të rritjes. Vënia në zbatim, në fillim të vitit 2007, e një seti rregullator që synon kontrollin e ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë, pritet të ndikojë në reduktimin e mëtejshëm të ekspansionit të kredisë. Vazhdimi i ngadalësimit të ritmeve të rritjes së kredisë në të ardhmen, do të sjellë vendosjen e saj në nivele më të qëndrueshme, në përputhje me stabilitetin makroekonomik të vendit.


Zgjatja e afatit të maturimit të kredive në portofolin e bankave si dhe rritja e kredive të reja të akorduara, janë faktorët kryesorë që kanë mbështetur rritjen e qëndrueshme të kredive në sistemin bankar. Për periudhën korrik- nëntor 2006, janë akorduar mesatarisht 13.4

miliardë lekë kredi e re në muaj ose 20 për qind mbi mesataren mujore të gjashtëmujorit të parë të vitit. Zhvillimet pozitive në muajt e verës, kanë përbërë të veçantën nga ecuria historike e deritanishme e kredisë. Po kështu, kredia e re e disbursuar në nëntor prej 15.9 miliardë lekësh ka shënuar maksimumin historik të kredisë të akorduar brenda një muaji.

Kredia në lekë përbënte 29.7 për qind të portofolit të kredisë në muajin nëntor, duke shënuar një zgjerim të lehtë të peshës së saj ndaj kredisë totale. Rritja e kredisë në lekë, prej më shumë se një viti, është reflektuar natyrshëm në reduktimin në 82.4 për qind të normës të rritjes vjetore për muajin nëntor, nga 140 për qind që shënonte një vit më parë. Në muajt gusht dhe shtator, kontributi i kredisë në lekë arriti deri në 40 për qind të ekspansionit të kredisë, duke u reduktuar më pas në normat karakterizuese të vitit 2006, rreth 36 për qind. Oferta e disa prej bankave kryesore gjatë periudhës së pushimeve verore për kredinë konsumatore me kosto të ulët, duket të ketë nxitur përshpejtimin e kredisë në lekë gjatë kësaj periudhe. Megjithë rritjen e shpejtë të kredisë në lekë, kredia në valutë dominon me 70.3 për qind portofolin e bankave. Kjo kredi ka shfaqur një performancë pozitive gjatë pjesës së dytë të vitit 2006. Norma vjetore e rritjes së saj për muajin nëntor shënoi 48 për qind, duke përbërë dhe normën më të lartë gjatë periudhës korrik- nëntor. Kredia në valutë ka demonstruar tendencë në rritje mbas muajit shtator, e lidhur kjo jo vetëm me rritjen e kreditimit të bizneseve në valutë por edhe me financimin e blerjeve në valutë të individëve.


Kredia për individët përbënte 7 për qind të PBB-së, në muajin nëntor. Bankat kanë ruajtur pothuajse të pandryshuar raportin e kësaj kredie ndaj totalit të kredisë gjatë muajve të fundit të vitit, rreth nivelit 33 për qind. Norma vjetore e rritjes së kredisë për individët në muajin nëntor shënoi 65 për qind, duke iu afruar niveleve më të ulëta të tre viteve të fundit. Më shumë se gjysma e kredisë për individët akordohet për financimin e blerjeve të pasurive të paluajtshme. Megjithatë, gjatë vitit 2006 vihet re një kreditim në rritje i individëve për financimin e blerjeve

Grafik 27. Normat vjetore të rritjes së kredisë sipas monedhave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Norma e rritjes së kredisë sipas monedhave dhe subjektit kredimarrës.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 29. Kredia për individë sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Kredia për biznese sipas qëllimit të përdorimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

të mallrave të konsumit. Raporti i kredisë për konsum në totalin e portofolit të individëve shënoi 30 për qind në muajin nëntor, nga 20 për qind që përbënte një vit më parë.

Kredia për bizneset në pjesën e dytë të vitit ka ruajtur ritme rritëse vjetore prej rreth 55 për qind. Struktura e shpërndarjes së kësaj kredisë sipas përdorimit të saj ka tentuar të bëhet më uniforme, në krahasim me një vit më parë. Pjesa më e madhe e kredisë për bizneset përdoret për blerjen e pajisjeve dhe makinerive. Ky destinacion përbën 33.3 për qind të saj. Ndërkohë, financimi i investimeve të bizneseve në zgjerimin e sipërfaqeve të kryerjes së aktivitetit ka patur një performancë mjaft të mirë gjatë vitit 2006, duke përbërë 24 për qind të kredisë së bizneseve në muajin nëntor.

Grafik 31. Norma e rritjes së indeksit të kredisë sipas sektorëve, me bazë dhjetor 2004.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Sektori i tregtisë ka vijuar të jetë sektori më atraktiv për tërheqjen e kredive nga sistemi bankar me 23.4 për qind të kredive, duke pasqyruar një rritje të lehtë nga fundi i gjashtëmuajorit të parë. Ndërkohë që sektori i bujqësisë ka vijuar të reduktojë peshën e tërheqjes të fondeve ndaj totalit, në 0.7 për qind nga 2.4 për qind që zinte një vit më parë¹³. Ecuria e indeksit të kredisë sipas sektorëve nxjerr në pah se kreditë për pasuritë e paluajtshme kanë paraqitur performancën më të mirë për vitin 2006, duke u stabilizuar në norma të larta të rritjes. Performanca pozitive e huamarrjes në tregun e banesave, ndiqet nga sektori i tregtisë. Ndërkohë, ritmet e rritjes së kredisë për këtë sektor kanë shënuar rënie gjatë muajve të fundit.

4.3.2 Mjetet valutore neto

Mjetet valutore neto të sistemit bankar kanë njohur një rritje të konsiderueshme, prej 260 milionë usd, gjatë pjesës së dytë të vitit. Kjo rritje është ndikuar më së shumti nga operacionet valutore të Bankës së Shqipërisë dhe nga rritja e depozitave në valutë pranë bankave tregtare. Nga ana tjetër, një pjesë e rritjes i dedikohet dhe mbiçmimit të euros kundrejt dollarit me rreth 3.8 për qind, duke rritur vlerën e investimeve në euro të shprehura në dollarë. Në mungesë të këtij efekti, rritja e mjeteve valutore neto të sistemit bankar për këtë periudhë, rezulton 198.8 milionë usd.

Në përgjithësi, zhvillimet në mjetet valutore në këtë periudhë të vitit kanë përkuar me sjelljen e tyre historike. Rritja e depozitave në valutë dhe ngadalësimi i kredisë gjatë tremujorit të tretë, kanë dhënë një ndikim pozitiv në nivelin e mjeteve valutore të bankave të nivelit të dytë. Ndonëse këto mjete pësuan ulje në tremujorin e katërt, në total, gjatë pjesës së dytë të vitit rritja e tyre shënon 113.5 milionë usd. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja e këtyre mjeteve rezultoi 96.2 milionë usd.

Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 146.5 milionë usd, gjatë periudhës korrik - nëntor. Kjo rritje ka ardhur nga ndërhyrjet në mënyrë të vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, për të përmbushur objektivin e saj për rezervën ndërkombëtare neto dhe për të zbutur luhatjet e tregut valutor. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë rezultoi 102.5 milionë usd.




Përsa i përket strukturës në valutë të mjeteve valutore të bankave tregtare gjatë pjesës së dytë të vitit, dollari amerikan ka zënë pjesën më të madhe të saj, me rreth 50 për qind. Bankat kanë të denominuara në dollarë pjesën më të madhe të letrave me vlerë të jorezidentëve dhe depozitat me afat në bankat e huaja. Arka dhe kreditë nga jorezidentët janë më së shumti në monedhën euro. Nga ana tjetër, rreth 70 për qind e detyrimeve valutore është e denominuar në euro, ku pjesa më e madhe përbëhet nga kredi nga bankat e huaja.

4.3.3 Kërkesa e qeverisë për para

Qeveria ka mbajtur në nivele pozitive balancën fiskale për pjesën më të madhe të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006. Pas muajit qershor, suficiti buxhetor ka ardhur në rënie, duke kaluar në nivele negative në muajin nëntor. Si rezultat i këtyre zhvillimeve kërkesa për para e qeverisë është përqendruar në tremujorin e fundit të vitit. Në këtë periudhë, financimi total kaloi në nivele pozitive, duke shënuar një rritje prej 16.6 miliardë lekësh. Projektionet fiskale parashikonin që niveli i financimit të brendshëm për vitin 2006 të arrinte në 22.8 miliardë lekë. Deri në muajin nëntor, ky financim rezultoi rreth 6.7 miliardë lekë.

Gjatë pjesës së dytë të vitit, qeveria është orientuar drejt emetimit të borxhit afatgjatë dhe ka reduktuar emetimin e bonove të thesarit. Kështu, më së shumti, financimi i brendshëm është mbuluar nëpërmjet emetimit të obligacioneve 2, 3 dhe 5 - vjeçare. Obligacionet me maturim 5-vjeçar u emetuan për herë të parë në muajin nëntor, në shumën 6.36

Grafik 33. Zhvillimet në financimin bruto të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



miliardë lekë. Përsa i përket obligacioneve 2 dhe 3 – vjeçare, për periudhën korrik – nëntor¹⁴, portofoli i tyre është rritur përkatësisht me 9.8 dhe 6.5 miliardë lekë.

Gjatë së njëjtës periudhë, niveli neto i bonove të thesarit të blera në tregun primar ka rënë në nivelin negativ prej 22 miliardë lekësh ose rreth 12.8 miliardë lekë më shumë se në pjesën e parë të vitit. Portofoli i bonove të thesarit ka shënuar një rënie prej 14.8 miliardë lekësh. Rreth 90 për qind e kësaj rënieje vjen nga reduktimi i portofolit të bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë.

Edhe gjatë pjesës së dytë të vitit, suficiti i krijuar është investuar nga qeveria në formën e repove të anasjellta për bankat tregtare.


Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, likuiditeti i tepërt i investuar në repo të anasjellta erdhi në rënie, duke rezultuar në 5.8 miliardë lekë ose rreth 5.2 miliardë lekë më pak se në muajin qershor. Për të njëjtën periudhë, niveli i depozitës së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë është rritur me 7.3 miliardë lekë.

4.4 ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE

Tregu i parasë dhe i letrave me vlerë

Gjashtëmujori i dytë është karakterizuar nga shtrëngimi i politikës monetare. Banka e Shqipërisë rriti dy herë normën bazë të interesit, në korik dhe në nëntor, përkatësisht me nga 25 pikë bazë, duke e çuar këtë normë në 5.50 për qind. Në ndjekje të sinjaleve shtrënguese, normat e interesit në tregun e parasë kanë qenë në rritje gjatë kësaj periudhe¹⁵.

Grafik 34. Normat afatshkurtra (majtas) dhe afatgjata (djathtas) të interesit në tregje.



Ndërsa në tremujorin e tretë Banka e Shqipërisë vazhdoi të tërhiqte likuiditet nëpërmjet ankandëve të rregullta të repove njëjavore (mesatarisht 2.9 miliardë lekë), në tremujorin e katërt kahu i operacioneve ndryshoi. Në kushtet kur u vu re mungesë likuiditeti në treg, Banka e Shqipërisë ndërhyri me repo të anasjellta për të injektuar likuiditet. Për sigurimin e nivelit të qëndrueshëm të tij, krahas repove të anasjellta njëjavore, në këtë periudhë u organizuan dhe ankande për repo të anasjellta me maturim njëmuajor dhe tremujor. Operacionet strukturore të këtij lloji kapën shumën totale 6.5 miliardë lekë.

Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve në tregun ndërbankar u ul në 1.6 miliardë lekë në gjashtëmuorin e dytë, nga 1.7 miliardë lekë në gjashtëmuorin e parë. Transaksionet shtatëditore shënojnë mesatarisht vlerën 0.9 miliardë lekë, duke ruajtur të njëjtin nivel me një gjashtëmuor më parë. Norma e interesit për këto transaksione është rritur me 9 pikë bazë, duke arritur vlerën 5.24 për qind në fund të muajit dhjetor.

Norma e interesit për transaksionet njëditore është ndikuar nga ndryshimi i raporteve kërkesë/ofertë. Ajo është ulur nga 5.00 për qind në tremujorin e tretë në 4.52 për qind në tremujorin e katërt, kur vëllimi i transaksioneve ka qenë më i lartë (mesatarisht me 0.9 miliardë lekë kundrejt 0.6 miliardë lekëve).


Emetimet e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar janë rritur në gjashtëmuorin e dytë, veçanërisht për maturime më të gjata se një vit. Portofoli i bonove të thesarit të sistemit bankar është ulur me 10.8 miliardë lekë, ndërkohë që ai me obligacione dyvjeçare dhe trevjeçare¹⁶ është rritur me 19.5 miliardë lekë. Për here të parë në muajin nëntor filloi emetimi i obligacioneve pesëvjeçare, *yield*-i i të cilave rezultoi 9.68 për qind.

Shtrengimi i politikës monetare dhe mosplotësimi në disa raste i kërkesës së qeverisë për likuiditet nga sistemi bankar, kanë bërë që *yield*-et e bonove të thesarit të rriten ndjeshëm krahasuar me gjashtëmuorin e parë, kur ato zbritën në minimume historike. Në fund të muajit dhjetor, *yield*-i për bonot e thesarit 12-mujore u ngjiti në 7.88 për qind ose 214 pikë bazë mbi atë të muajit qershor¹⁷. Për obligacionet dyvjeçare dhe trevjeçare, *yield*-et u rritën përkatësisht në 8.40 për qind dhe 8.80 për qind nga 6.38 për qind dhe 7.50 për qind që ishin në muajin qershor.


Normat e interesit në sistemin bankar

Sipas të dhënave më të fundit, gjatë muajit nëntor ka pasur rritje të interesave të depozitave dhe kredive në lekë në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të depozitave 2-vjeçare dhe të kredive nga 6 muaj–1 vit. Rritja e interesave ka qenë reagim i këtyre tregjeve ndaj politikës shtrenguese të Bankës së Shqipërisë, si dhe i rritjes së kërkesës për kredi dhe për likuiditete. Në krahasim me muajin qershor, rritja

Grafik 35. Interesat e huamarrjes në tregun ndërbankar dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë.



Grafik 36. *Yield*-i i bonove të thesarit dhe i obligacioneve 2-vjeçare.



e interesave të kredive ka tejkalluar rritjen e sinjalizuar nga Banka e Shqipërisë, ndërkohë që, interesat e depozitave në lekë nuk kanë ndjekur të njëjtin ritëm. Bankat kanë qenë më të rezervuara në rritjen e interesave të depozitave në lekë, për shkak se sistemi ka rezultuar në përgjithësi me teprica likuiditeti në periudhën qershor-nëntor 2006. Rritja më e shpejtë e interesave të kredive krahasuar me atë të depozitave, ka sjellë rritjen e kostos së ndërmjetësimit¹⁸.

Tabelë 18. Kostoja e ndërmjetësimit në lekë.

	Nëntor-05	Qershor-06	Nëntor-06
Kredi-depozita 6-mujore	8.47%	6.93%	11.1%↑
Kredi-depozita 1-vjeçare	7.84%	6.75%	8.7%↑

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtrengimi i politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006¹⁹, ka ndikuar në rritjen e interesave të depozitave dhe kredive në euro për të gjitha afatet²⁰. Në muajin nëntor, interesi mesatar i ponderuar i kredive në euro arriti në 8.02 për qind nga 7.75 për qind që ishte në fund të gjashtëmujorit të parë.

Për sa i përket interesave në dollarë, në kushtet e një politike shtrënguese të sinjalizuar nga Rezerva Federale në fund të muajit qershor 2006, tendenca e përgjithshme ka qenë rritja e tyre si për depozitat ashtu dhe për kreditë. Në nivel mesatar interesat e kredive në dollarë për të gjitha afatet janë rritur nga 9.85 për qind në muajin qershor, në 9.96 për qind në muajin nëntor 2006. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, interesat e depozitave në dollarë janë rritur thuajse në të gjitha afatet, duke tejkalluar, në shumicën e rasteve, rritjen e sinjalizuar nga Rezerva Federale²¹. Pritshmëritë për uljen e normës bazë të interesit nga Rezerva Federale në muajt e ardhshëm, kanë bërë që në muajin nëntor të shfaqen raste të uljes së interesave në depozitat pa afat, depozitat 1-mujore, depozitat 2-vjeçare, kreditë deri në 6-muaj dhe kreditë nga 6 muaj deri në 1-vit.

Diferenca e interesave të depozitave lekë-valutë për afatet 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore ka pasur në përgjithësi²² tendencë rënëse. Rritja e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë në muajin nëntor, pritet të ndikojë në drejtim të rritjes së kësaj difference.

Tabelë 19. Diferenca e interesave të depozitave lekë-valutë.

	Dhjetor 2005	Qershor 2006	Nëntor 2006
lekë-dollarë			
3 - mujore	1.6%	0.2%	0.3%
6 - mujore	2.1%	0.9%	0.7%
12 -mujore	2.1%	1.2%	0.5%
lekë-euro			
3 - mujore	2.2%	1.3%	1.0%
6 - mujore	2.8%	1.4%	1.4%
12 -mujore	3.1%	2.0%	1.9%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet *spread*-i i interesave realë të depozitave në lekë ndaj atyre në valutë për afatet 12-mujore, i cili vazhdon të ketë tendencë rënëse.

Ecuria e kursit të këmbimit

Zhvillimet në kursin e këmbimit të lekut, gjatë pjesës së dytë të vitit 2006, kanë konfirmuar ngadalësimin e trendit mbiçmues të tij kundrejt monedhave kryesore. Në terma vjetorë nominalë efektivë, leku është mbiçmuar mesatarisht gjatë vitit 2006 me 1.1 për qind ndërsa një vit më parë ky mbiçmim ishte 2.8 për qind.


Dobësimi i dollarit në tregun ndërkombëtar valutash ka vazhduar të favorizojë prirjen mbiçmuese të lekut kundrejt dollarit edhe gjatë gjyshtëmujorit të dytë. Nga ana tjetër, leku ka qenë më i qëndrueshëm kundrejt euros, me prirje të lehtë nënçmuese.

Gjatë muajve të verës leku është përballur me një efekt më të zbehtë sezonal, krahasuar me vitet e mëparshme. Edhe pse në pjesën e dytë të vitit leku ka paraqitur një luhatshmëri më të lartë kundrejt euros sesa në pjesën e parë të tij, kjo luhatshmëri i është përmbajtur trendit rënës të vrojtuar ndër vite. Stabiliteti i lekut ka ardhur si rezultat i përmirësimit të funksionimit të tregut valutash dhe si kombinim i zhvillimeve në një sërë faktorësh makroekonomikë si, rritje e qëndrueshme ekonomike, inflacion i ulët, transparencë dhe ulje e pasigurisë mbi ecurinë e këtyre treguesve në të ardhmen.

5. ECURIA E PRITSHME E EKONOMISË GJATË VITIT 2007


Aktiviteti ekonomik ka patur tendencë pozitive zhvillimi gjatë viteve të fundit. Ekonomia është rritur me rreth 5-6 për qind në terma realë, ndërsa norma e investimeve në ekonomi është rritur në mbi 25 për qind e PBB-së në vitin 2006, kundrejt normave prej 23-24 për qind në vitet e mëparshme. Kuadri aktual makroekonomik merr parasysh ecurinë e treguesve fiskalë dhe atyre monetarë, ndërsa tendencat e treguesve të sektorit të jashtëm janë në përputhje me

Grafik 37. *Spread*-i i interesave realë të depozitave në lekë ndaj atyre në valutë për afatet 12-mujore (në përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Ecuria e lekut në terma nominale efektivë (NEER²³).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 39. Luhatshmëria²⁴ e këmbimit të lekut në tremujorë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

rritjen ekonomike të parashikuar. Në tërësi, për vitin 2007, situata makroekonomike mbetet e favorshme ndërsa realizimi i treguesve të projektuar për këtë vit parashikohet të mundësojë një rritje ekonomike prej rreth 6 për qind.

Tabelë 20. Treguesit kryesorë makroekonomikë.

	2002	2003	2004	2005	2006*	2007•
Treguesit e ekonomisë reale	(në pikë përqindjeje)					
Rritja PBB	2.9	5.7	5.9	5.5	5.0	6.0
IÇK vjetor (mesatar)	5.2	2.4	2.9	2.5	2.4	3.0
PBB nominale (miliardë lekë)	624.7	682.7	766.1	836.6	896.3	978.9
Treguesit fiskalë	(në përqindje ndaj PBB-së)					
Deficiti fiskal (me grante)	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1	-3.9
Huamarrja e brendshme	-3.3	-2.9	-2.3	-2.7	-2.2	-2.0
Të ardhura	24.7	24.5	24.1	24.4	25.7	25.9
Shpenzime	31.4	29.0	29.2	28.0	28.9	29.8
Sektori i jashtëm						
Deficiti tregtar (milionë euro)	-1,214	-1,248	-1,307	-1,617	-1,707	-1,853
Deficiti llogarisë korente (% PBB)	-10.0	-8.1	-5.5	-7.5	-7.2	-7.5
Treguesit monetarë	(në përqindje ndaj PBB-së)					
Oferta monetare	65.3	65.0	65.7	68.4	73.3	75.0
Kredia për sektorin privat	6.4	7.7	9.4	14.9	20.8	25.5
Interesi i bonove thesarit 12-mujore	12.0	9.5	8.1	6.9	7.8	--

* Të dhëna paraprake. • Parashikime.

** Deficiti primar përjashton shpenzimet e interesave të borxhit të qeverisë.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, INSTAT.

Bilanci Makroekonomik dhe Sektori fiskal

Kuadri makroekonomik për vitin 2007 parashikon një rritje të lehtë të kursimeve të brendshme në ekonomi në rreth 19.9 për qind të PBB-së kundrejt 19.2 për qind në vitin 2007, kryesisht nga sektori privat. Kjo rritje pritët të kanalizohet tërësisht në financimin e investimeve shtesë. Niveli mesatar i investimeve në vitet e fundit është luhatur afër 24 për qind ndaj PBB-së dhe rritja e tyre në 26 për qind, në vitin 2007, parashikohet të përmirësojë ecurinë e eksporteve në ekonomi në periudhat e ardhshme. Në këto kushte, bilanci kursime-investime parashikohet në rreth 6.2 për qind. Ky raport i lartë supozon përkeqësim të llogarisë korente (në të njëjtin nivel prej 6.2 për qind), megjithëse bilanci i eksport-importeve luhetet në 23.3 për qind, sikurse në vitin 2006²⁵.

Vlerësohet pozitiv fakti që rritja e bilancit makroekonomik të kursim-investimeve dhe përkeqësimi i llogarisë korente janë rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së investimeve, tendencë e cila promovon rritjen ekonomike dhe të eksporteve në periudhën afatgjatë. Gjithashtu, niveli më i lartë i kursimeve bazohet tërësisht në rritjen e kursimeve të sektorit privat, ndërsa niveli i kursimeve të sektorit publik është projektuar në rreth 2.5 për qind të PBB-së, sikurse në vitin 2006.

Kontributi i llogarisë fiskale në rritjen e bilancit të kursim-investimeve parashikohet në rreth 4.6 për qind të PBB-së, ndërsa pjesa tjetër përbën

deficit të sektorit privat. Projektionet fiskale të qeverisë parashikojnë financim të deficitit fiskal nëpërmjet huamarrjes së brendshme në masën 2.5 për qind dhe financim nga burime të jashtme, në rreth 2 për qind²⁶.

Sektori monetar

Bazuar në projektionet e rritjes së kredisë për sektorin privat dhe të huamarrjes së qeverisë, paraja e gjerë parashikohet të rritet me rreth 11.9 për qind për vitin 2007. Gjithashtu, rritja e agregatit më të ngushtë të parasë, M2, parashikohet në rreth 11.4 për qind.

Rritja e ofertës monetare gjatë vitit 2007, do të vijë si rezultat i rritjes së kreditimit të ekonomisë me rreth 63.3 miliardë lekë dhe i financimit të huamarrjes së qeverisë nga sistemi bankar, me rreth 12 miliardë lekë. Pjesa tjetër e huamarrjes së brendshme për financimin e deficitit, parashikohet të mbulohet nga institucionet e tjera financiare dhe individët. Parashikimet aktuale të ofertës monetare dhe treguesve të kredisë kushtëzohen nga qëndrimet e politikës monetare kundrejt parashikimeve të inflacionit. Rritja e projektuar e ofertës monetare për vitin 2007 është në përputhje me një normë mesatare të inflacionit prej rreth 3 për qind. Zhvillimi dhe thellimi i mëtejshëm i tregjeve financiare pritet të ndikohen pozitivisht nga prania e instrumenteve me afat të gjatë maturimi të letrave me vlerë të qeverisë. Dinamika e kërkesës për para kërkon ruajtjen e tendencës së normave të interesave në treg, në kahun rritës. Gjithashtu, qëndrueshmëria e llogarisë së jashtme dhe parashikimet për një normë inflacioni afër objektivit, pritet të japin kontributin pozitiv në ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit.

SHËNIME

¹ FOMC- Federal Open Market Committee.

² Kursi real efektiv llogaritet si një mesatare e peshuar e kursit të këmbimit të një monedhe kundrejt një shporte me monedhat e partnerëve kryesorë tregtarë të vendit në shqyrtim.

³ Në këtë klasifikim nuk përfshihet dega e bujqësisë. Dega e agroindustrisë përfshihet në kategorinë 'industria përpunuese'.

⁴ Sipas buxhetit suplementar.

⁵ Duke iu referuar kursit nominal efektiv të këmbimit që llogaritet nga Banka e Shqipërisë.

⁶ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁷ Burimi: Shërbimi Kombëtar Statistikor i Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

⁸ Burimi: Eurostat, faqja e internetit <http://epp.eurostat.cec.eu.int>

⁹ Burimi: Shërbimi Kombëtar Statistikor i Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>.

¹⁰ Burimi: Instituti i Statistikave të Italisë; faqja e internetit <http://www.istat.it>.

¹¹ Burimi: EUROSTAT; faqja e internetit <http://epp.eurostat.cec.eu.int>.

¹² Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë janë pjesë e marrëveshjes së re PRGF/EFF 2006-2008 e nënshkruar midis qeverisë shqiptare, FMN-së dhe Bankës së Shqipërisë, në muajin janar të vitit 2006.

¹³ Reduktimi i ndjeshëm i kredisë për bujqësinë që vihet re në muajin qershor 2006 e në vazhdim, reflekton kryesisht ndryshimet në raportim, sipas rivlerësimit të portofolit të kredisë të një prej bankave kryesore në sektorin bankar.

¹⁴ Të dhënat operative për muajin dhjetor tregojnë që qeveria ka emetuar vetëm obligacione 2 - vjeçare në shumën 3 miliardë lekë.

¹⁵ Shih: Shtojca Statistikore; Tregjet financiare; Tabela: "Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme".

¹⁶ Emetuar për herë të parë në muajin prill 2006.

¹⁷ Shih: Shtojca Statistikore; Tregjet financiare; Tabela: "Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme".

¹⁸ Diferenca e interesave të kredive dhe depozitave në lekë për afatet 6- dhe 12-mujore.

¹⁹ Të dhënat më të fundit i përkasin muajit nëntor 2006.

²⁰ Me përjashtim të interesave të depozitave pa afat dhe interesave të kredive me afat 1-3 vjet.

²¹ Shih: Shtojca Statistikore; Tregjet financiare; Tabela: "Normat e interesit të depozitave në valutë".

²² Këtu bëjnë përjashtim interesat e depozitave 3-mujore në lekë dhe në euro, diferenca e të cilave është rritur në krahasim me qershorin.

²³ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë,

euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind). Dhjetor 2001: NEER = 100. Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut.


²⁴ Llogaritur si mesatare tremujore e luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur si devijim standard $\sum (x_i - \bar{x})^2/n - 1$, x_i - kursi i këmbimit në periudhën i , \bar{x} - mesatarja e periudhës i (për shembull, kursi i këmbimit në një ditë të muajit të caktuar në vitin i minus kursin mesatar të muajit në vitin i).

²⁵ Diferenca përkon me përkeqësimin e bilancit të të ardhurave nga transfertat nga jashtë.

²⁶ Sipas të dhënave të buxhetit të qeverisë të miratuar në Parlament, i cili parashikon të ardhura nga privatizimet prej rreth 0.1 për qind të PBB-së.


SHTOJCË STATISTIKORE

Gafik 1. Treguesi i shitjeve reale (në vlerë absolute).




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Gafik 3. Inflacioni vjetor (në përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Gafik 5. Deficiti total dhe primar (në përqindje).




Burimi: Ministria e Financave.

Gafik 7. Bilanci mujor tregtar dhe llogaria korente (në miliardë usd).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Gafik 4. Shenzime fiskale kumulative dhe aktuale (në përqindje).




Burimi: Ministria e Financave.

Gafik 6. Rritja vjetore e importeve dhe eksporteve (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gafik 8. Llogaria korente dhe deficiti tregtarë në përqindje të PBB-së.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

INFLACIONI.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6	1.5
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	2.4
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8	3.2
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.9
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	2.6
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	2.3
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	2.9
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.4	2.4

Burimi: INSTAT.

Tabelë 2. Kontributi në inflacionin total i grupeve përbërëse të shportës.

	Mars-06	Prill -06	Maj-06	Qershor-06	Korrik-06	Gusht -06	Shtator-06	Tetor -06	Nëntor-06	Dhjetor-06
Ushqime dhe pije joalkolike	0.16	1.03	1.51	0.80	1.86	0.51	-0.45	-0.59	0.45	0.09
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	0.85	0.84	1.00	1.04	0.88	1.78	2.32	2.19	1.91	1.87
Transport	0.14	0.13	0.23	0.24	0.19	0.13	0.10	0.09	0.08	0.05
Hotele, kafe dhe restorant	0.20	0.22	0.22	0.22	0.16	0.18	0.18	0.15	0.15	0.14
Të tjera	0.11	0.12	0.10	0.15	0.15	0.24	0.40	0.40	0.32	0.40
Totali	1.48	2.35	3.1	2.45	3.24	2.84	2.55	2.24	2.91	2.55

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

TREGUESIT MONETARË.

Tabelë 3. Ecuria e agregatëve monetarë (në miliardë lekë).

	Nëntor- 06	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
		Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	146.3	0.5	0.3	6.6	4.8
Depozitat totale	491.7	2.2	0.5	65.4	15.3
- në lekë	303.3	3.2	1.1	29.4	10.7
- në valutë	188.4	-1.0	-0.5	36.0	23.6
Depozita pa afat	146.9	-3.4	-2.3	15.9	12.2
- në lekë	80.5	0.8	1.1	4.6	6.0
- në valutë	66.3	-4.3	-6.1	11.3	20.6
Depozita me afat	344.9	5.7	1.7	49.5	16.7
- në lekë	222.7	2.4	1.1	24.8	12.5
- në valutë	122.1	3.3	2.7	24.7	25.3
M1	226.9	1.3	0.6	11.2	5.2
M2	449.6	3.7	0.8	36.0	8.7
M3	638.0	2.7	0.4	72.0	12.7
Baza monetare	209.3	3.6	1.7	20.4	10.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Ecuria e treguesve të MVN sipas grupeve kryesore (në milionë usd).

	Nëntor - 06	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Mjete valutore neto	2,440.7	35.7	393.4
Mjete valutore			
Banka e Shqipërisë	1,700.0	45.0	332.5
BPD	1,105.6	18.6	196.1
Deturime valutore			
Banka e Shqipërisë	108.8	1.9	3.1
BPD	256.1	26.0	132.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Pretendime Neto për Qeverinë sipas grupeve kryesore (në milionë leke).

	Nëntor- 06	Ndryshime mujore	Ndryshime vjetore
Pretendime ndaj qeverisë neto	275,738.3	1,258.5	- 3,014.5
Banka e Shqipërisë	50,229.1	- 2,203.2	- 7,291.3
BPD	225,509.2	3,461.7	4,276.8
Depozita pranë Bankës së Shqipërisë	10,655.9	2,949.4	6,297.1
Deficiti buxhetor	- 27.4	- 3,448.2	11,845.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2003	2004	2005		2006	
			6 mujori I	6-mujori II	6 mujori I	Nëntor
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	448.4	507.2	541.8	578.04	594.5	638.0
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	71.5	68.9	69.9	70.03	71.0	71.4
Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	60.2	55.1	52.2	48.94	45.3	43.2
Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	11.3	13.8	17.7	21.10	25.71	28.1
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	13.7	16.9	20.8	25.11	28.7	31.0
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	6.8	9.0	11.2	14.57	17.6	20.1
Raporti kredi / depozita (në %)	15.7	19.0	23.6	28.47	33.7	36.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 7. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

	2003	2004	2005	T1-06	T2- 06	T3 '06	Tetor 06	Nëntor '06
Teprica e kredisë (në miliardë lekë)	50.7	69.3	121.6	134.6	152.8	165.3	172.8	179.5
Kredi për individët	24.5	30.6	32.3	31.9	32.3	33.3	33.3	33.4
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	67.7	68.1	67.6	66.7	66.7	66.6
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	32.3	32.5	31.1	30.0	29.6	28.8
Kredi afatmesme	33.3	36.0	29.7	30.0	31.2	32.6	32.3	33.2
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	37.9	37.5	37.7	37.4	38.1	37.9
Lekë	19.6	19.5	26.6	26.0	28.2	29.8	29.4	29.7
Valutë	80.4	80.5	73.4	74.0	71.8	70.2	70.6	70.3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 8. Tregues të kredisë së re në përqindje ndaj totalit.

	2004	2005				2006			
	Total	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	Nëntor
Kredia e re (në miliardë lekë)	99.7	22.1	32.8	32.1	32.9	29.4	35.7	35.8	15.9
Kredi afatshkurtër	62.54	53.2	47	47.4	48.7	44.2	42	45.8	56.2
Kredi afatmesme	22.53	22.4	31	30.3	25.6	30.1	33	31.2	22.6
Kredi afatgjatë	14.93	24.4	22	22.2	25.7	25.7	26	23.0	22.2
Kredi në lekë	32.59	30.1	32.8	30.2	31.4	27.7	35	39.6	27.6
Kredi në valutë	67.41	70	67.2	69.8	68.6	72.3	65	61.4	73.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 9. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë (në përqindje ndaj totalit).

	2004	2005				2006				
	Total	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	Tetor	Nëntor
Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	1.5	1.3	1.5	2.4	2.7	2.2	0.9	0.7	0.7	0.7
Peshkimi	0.1	0.01	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.11	0.1	0.1
Industria Nxjerrëse	0.3	2.35	0.6	0.5	0.5	1.4	2.3	1.0	0.9	0.9
Industria Përpunuese	17.1	15.8	15.6	13.9	13.8	14.2	15.3	15.5	14.9	14.5
Prodhimi, Shpërndarja e Energjisë elektrike e Gazit dhe e Ujit	2.8	6.27	2.9	2.9	2.6	2.4	1.1	1.2	1.6	1.5
Ndërtimi	9.8	10.6	11.2	12.8	13	13.0	12.2	12.6	12.2	12.1
Tregtia, Riparimi i Automobilitave dhe Artikujve Shtëpiake	23.3	20.5	19.1	20	18.9	19.0	22.5	23.1	23.2	23.4
Hotele dhe Restorante	8.3	2.5	4.7	4.4	4.3	4.8	4.1	3.9	3.7	3.6
Transporti dhe Telekomunikacioni	2	2.5	1.7	1.7	1.5	1.3	1.6	1.6	1.6	2.0
Aktivitetet Financiare	0.2	0.2	1.1	0.7	0.8	0.7	1.3	0.7	1.4	1.3
Shëndeti dhe Veprimtaritë Sociale	0.5	0.1	0.4	0.6	0.7	0.6	0.6	0.3	0.3	0.2
Shërbime kolektive, Sociale dhe Personale	4.8	8.3	7.4	5.9	5.8	4.6	1.7	2.0	2.1	2.1
Te tjera*	29.1	29.6	33.7	34.1	35.4	35.7	36.2	35.1	37.5	37.7
Total	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Zëri "të tjera" përfshin kredinë e akorduar disa sektorëve me peshë të vogël në aktivitetin ekonomik të vendit si dhe kredinë për individët. Me prezantimin e ri të formularëve të kredisë është kërkuar një rishikim i shpërndarjes së kredisë sipas sektorëve ku u prezantua rindarja e re.

TREGJET FINANCIARE.

Tabelë 10. Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme (në pikë përqindje).

	Dhjetor '06	Ndryshimi dhjetor'06-nëntor'06	Ndryshimi dhjetor'06-qershor'06
Norma bazë e interesit*	5.50%	+0.25	+0.50
Tregu ndërbankar			
Interesi i tregut ndërbankar 1- ditor	4.52	+0.42	+0.31
Interesi i tregut ndërbankar 7- ditor	5.24	+0.26	+0.09
Tregu primar			
yield-i i bono thesarit 3- mujore	6.25%	+0.01	+1.02
yield-i i bono thesarit 6- mujore	7.18%	+0.31	+1.76
yield-i i bono thesarit 12- mujore	7.88%	+0.34	+2.14
Tregu i obligacioneve			
yield-i i obligacioneve 2- vjeçare	8.40%	0.00	+2.01
yield-i i obligacioneve 3- vjeçare	8.80%	-	+1.30
yield-i i obligacioneve 5- vjeçare	9.68%	-	-

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

* Gjatë gjithë muajit nëntor norma bazë e interesit ka qene 5.25 për qind dhe në fund të muajit nëntor (datë 30 nëntor), norma e interesit u rrit në nivelin 5.50 për qind.

Tabelë 11. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave dhe të kredive në lekë (në pikë përqindjeje).

	Nëntor '06	Ndryshimi nëntor'06-tetor'06	Ndryshimi nëntor'06- qershor'06
Norma bazë e interesit	5.25	0.00	0.25
Interesi i depozitave në lekë			
3 – mujore	3.86%	0.01	0.12
6 – mujore	4.51%	0.01	0.16
12 - mujore	5.33%	0.13	0.28
24- mujore	5.59%	-0.19	-0.31
Interesi i kredive në lekë			
Kredi deri në 6 muaj	15.61%	0.41	4.33
Kredi 6 muaj- 1 vit	13.99%	-1.23	2.19
Kredi 1-3 vjet	17.26%	0.42	1.37
Kredi mbi 3 vjet	13.03%	0.68	1.61

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 12. Normat e interesit të depozitave në valutë (në pikë përqindjeje).

	Nëntor- 06	Ndryshimi nëntor'06-tetor'06	Ndryshimi nëntor'06- qershor'06
Fed-norma bazë e interesit	5.25%	+0.00	+0.25
Interesi i depozitave në usd			
1 – mujore	3.01%	-0.07	0.67
3 – mujore	3.61%	0.09	0.08
6 – mujore	3.81%	0.05	0.40
12 - mujore	4.79%	0.20	0.97
24 - mujore	4.72%	-0.04	0.34
BQE-norma bazë e interesit	3.25%	+0.25	+0.75
Interesat e depozitave në euro			
1 – mujore	2.71%	0.24	0.58
3 – mujore	2.85%	0.08	0.42
6 - mujore	3.10%	-0.07	0.19
12 - mujore	3.45%	0.03	0.41
24 - mujore	4.13%	0.07	0.50

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 13. Spread-i i normës së interesit depozitë - kredi në lekë dhe në valutë .

Spread-i interesit të depozitave:				
	lek-usd		lek-euro	
	qershor'06	nëntor'06	qershor'06	nëntor '06
3 – mujore	0.21%	0.25%	1.31%	1.01%
6 - mujore	0.94%	0.70%	1.44%	1.41%
12 -mujore	1.23%	0.54%	2.01%	1.88%
Spread-i i interesave të kredive:				
	lek-usd		lek-euro	
	qershor'06	nëntor '06	qershor'06	nëntor '06
6- mujore	2.00%	6.82%	2.99%	6.83%
6 mujore -1 vit	0.58%	2.42%	4.45%	6.48%
1-3 vjet	6.25%	7.25%	7.45%	9.88%
mbi 3 vjet	2.64%	3.87%	3.76%	4.76%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.07, datë 31.01.2007

PËR
PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 05.05.1999 të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 8 me titull "Mënyra e llogaritjes", shtohet pika 8.1.5 me këtë përmbajtje:

8.1.5 Ponderohet me koeficient 150 për qind:

Vlera e portofolit të kredisë që tejkalon kufijtë e treguesve të përcaktuar në nenin 22/2, shkronja c, të rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

b) Në formularin 1 me titull "Zërat e aktivitetit të ponderuar me rrezikun", shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. Aktive me koeficient ponderimi 150 për qind, sipas pikës 8.1.5 të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit

Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.08, datë 31.01.2007

PËR

“ZGJATJEN E AFATIT NJËVJEÇAR TË VLEFSHMËRISË SË MIRATIMIT
PARAPRAK TË LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE,
BANKËS SË PROPOZUAR “BANKA E PARË E INVESTIMEVE-SHQIPËRI
SH.A.””

Në bazë dhe për zbatim të nenit 10, pika 4, shkronja “c” të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3, pika 4, shkronja “c” dhe të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të zgjasë afatin njëvjeçar të vlefshmërisë së miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, për bankën e propozuar “Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri sh.a”, për një periudhë prej 6 muajsh nga data e përfundimit të afatit.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 1,
JANAR 2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.01, datë 17.01.2007 "Për miratimin e "Kalendarit të mbledhjeve dhe programit të punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 17.01.2007 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 17.01.2007 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 340 kopje